




ISLAMI i lehtësuar

Një varg serik edukativ i diturisë ku lexuesi do të njihet me fenë Islame. Nëpërmes këtij libri ti lexues do të mësoh atë më të rëndësishmen me të cilën të obligoi Krijuesi yt Madhështor.

Vlera e kësaj serie fshihet në tërësinë e saj midis kualitetit të lartë të njohjes dhe lehtësisë së metodës, e cila të bënë që ta kuptosh sa më mirë përmbajtjen, duke mos kërkuar ndihmën e të tjerëve përveç rasteve të rralla.

Ali Hasen Abdul Hamid

Ali Hasen Abdul Hamid

ISLAMI I LEHTËSUAR

**Përktheu: Enis Rama
Mitrovicë**

2008

**Boton (Shtyp):
LRM- Junik**

{Lidhja e të Rinjve Muslimanë}

Përdorimi i librit - nxjerrja e tij në shtyp është lejuar nga rekomandimi i përkthyesit dhe albislam.com vetëm për qëllime daveti dhe nuk lejohet për përdorim fitimprurës. Përndryshe, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk lejohet të riprodhohet, të strehohet në ndonjë sistem riprodhues, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me anë të çfarëdo mjeti, pa lejen paraprake të botuesit. Albislam.Com ka siguruar lejen e nevojshme që t'i publikojë këto libra në WWW.

Hyrje

Falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve, paqeja dhe shpëtimi qofshin mbi zotëriun e pejgamberëve, Muhammedin sal-l-all-llahu alejhi ve selem mbi familjen dhe shokët e tij.

I dashur musliman: Ky është një varg serik edukativ i diturisë ku do të njihesh me fenë tënde "Islamin" nëpërmes së cilës do të mësosh atë më të rëndësishmen me të cilën të obligoi Krijuesi yt Madhështor: All-llahu, e gjithashtu do të njihesh edhe me jetën dhe traditën e pejgamberit tënd fisnik: me Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve selem dhe me tërë atë që ka të bëjë me këtë prej besimit, shitblerjes, adhurimit dhe moralit.

Vlera e kësaj serie fshihet në tërësinë e saj midis kualitetit të lartë të njohjes, lehtësisë së metodës, e cila të bënë që ta kuptosh sa më mirë, duke mos kërkuar ndihmën e ndonjërit prej familjes apo të afërmeve të tu përveç se në raste të rralla. Lus All-llahun që të kesh dobi nga kjo, vërtetë Ai Dëgjon dhe Përgjigjet.

ALL-LLAHU i Lartëmadhëruar

Dije se vërtetë të njohurit e All-llahut xhel-le shanuhu, besimi në Të, adhurimi ndaj Tij dhe vërtetimi i gjithë asaj që vjen nga Ai është nga gjërat më të rëndësishme me të cilën obligohet muslimani që ta mësojë, ta njeh dhe kuptojë.

E ai i cili nuk e njohi All-llahun, Krijuesin, Sunduesin dhe Udhëheqësin e tij, ai vërtetë ka jetuar në jetën e kësaj bote si shtazë: han dhe pinë, flenë dhe zgjohet, e kështu me radhë derisa të përfundojë jeta e tij në këtë gjendje e ai nuk e din as për çka është krijuar dhe si ka jetuar

All-llahu i Lartësuar thotë: " ... **e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri.**" (Suretu Muhammed: 12).

E kështu ata do të bëjnë çrregullime në tokë, do të bëjnë keq me punët e tyre, ngase ata nuk i njohin punët e mira dhe nuk dinë se cilat janë punët e këqija, nuk dinë se çka e hidhëron All-llahun dhe nuk mendojnë për atë që e bënë Atë të kënaqur.

2) Do të thotë asnjë njeri nuk mundet t'i njeh rrugët e mira për t'i shërbyer ndonjë sendi vetëm se me udhëzimin e atij që është më i ditur se ai, e si mundet pra njeriu në jetën e kësaj bote që ta luaj rolin e tij të kërkuar duke mos i përfillur urdhrat dhe obligimet e All-llahut të Madhëruar, e Ai është- i Lartësuar qoftë- Krijues i njeriut dhe Krijues i gjithë botërave. All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "**A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësitë sekreteve, i njeh hollësitë.**" (Suretul-Mulk: 14).

3) Ai i cili nuk e njeh All-llahun si Krijues të tij, i shkatërron veprat e tij, ngase ai nuk e ka kuptuar fuqinë e Atij i cili udhëzon në rrugën e të vërtetës, fitores dhe shpëtimit, e Ai është All-llahu xhel-le shanuhu.

Këto sëmundje të cilat janë përhapur në tokë, ky çrregullim i madh i cili është prezent mes njerëzve ndodh vetëm nga shkaku i largimit të njerëzve nga udhëzimet e Krijuesit të Madhëruar dhe refuzimi për zbatimin e urdhrave të Tij.

4) E pastaj përfundon jeta e atyre të cilët nuk e njohën Zotin si Krijues të tyre, duke mos ditur as pse ka filluar? Dalin prej saj duke mos ditur as pse kanë hyrë në të?

5) Por ai i cili e njohu Zotin e tij, besoi në Të dhe vërtetoi gjithë atë që i erdhi prej Tij, ky është ai të cilin do ta ndihmon All-llahu i Madhëruar.

All-llahu i Lartësuar në Kur'anin Fisnik thotë:

"E All-llahu patjetër do ta ndihmon atë që ndihmon rrugën e Tij." (Suretul-Haxh: 40).

6) Njeriu: kjo krijesë e cila posedon gjymtyrë si dora, këmba, koka e të tjera, obligohet që t'i njeh detyrat e kërkuara nga ai për t'i lëvizur këto gjymtyrë.

Kjo bëhet vetëm duke i njohur urdhrat me të cilat e obligoi All-llahu xhel-le shanuhu këtë njeri. Çdo njeri ka mendje, e detyrë e mendjes është të logjikuarit, e kur të mos funksionon kjo detyrë shkatërrohet puna e mendjes, ndërpritet nga puna e saj kryesore e pikërisht kjo bëhet shkak që të largohet nga e mira dhe të afrohet kah e keqja.

7) All-llahu xh. sh. na ka thirrur në Kur'anin Fisnik të logjikojmë në atë që jemi dhe ka thënë: **"Thuaj: "A është i barabartë i verbëri me atë që sheh?" "A nuk mendoni?"**

(Suretul-En'am 50).

Dhe gjithashtu thotë:

"Dhe a nuk menduan ata në veten e tyre...?" (Sureturr-Rrum).

All-llahu xhel-le shanuhu kur i ka thirrur krijesat e Tij në të logjikuar e ka bërë këtë brenda fuqisë dhe mundësisë së mendjes së tyre.

Gjithashtu i Madhëruari na ka ftuar në shikimin e asaj që ka krijuar në qiej dhe në tokë, në vetën tonë dhe në të gjitha krijesat. Na ka thirrur që të logjikojmë në krijimin e kësaj gjithësie ta gjerë e cila e tëra është prej krijaturës së All-llahut i Cili është larg çdo të mete.

8) Pasi që njeriu të logjikojë dhe të meditojë do të përfundojë se, kjo gjithësi e gjerë dhe e madhe ka Krijues Madhështor, Sajues të Urtë e Ai është All-llahu, Zoti jonë i Madhëruar qoftë.

Krijues i njeriut, bimëve dhe kafshëve.

Krijues i qiejve, tokës dhe detërave.

Krijues i çdo sendi që e shohim në kë këtë gjithësi të madhe.

9) All-llahu xhel-le shanuhu është cilësuar me cilësi të qarta (të pastra, të plota) me të cilat e ka cilësuar qenien e Tij Madhështore në Kur'anin Fisnik, e gjithashtu e ka cilësuar krijesa më e ditur për Të, e ai është i dërguari i fundit Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem. E prej këtyre cilësive janë: Mëshira; Krenaria; Falja; Poshtërimi. E shumë të tjera të cilat gjinden në Kur'anin Fisnik dhe në hadithet e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve selem. E qëllimi ynë kryesor në njohjen e këtyre cilësive është që të ndalemi para dobësisë sonë dhe nevojës sonë për këtë Hyjni Madhështore që është larg çdo të mete dhe mangësie.

10) All-llahu xhel-le shanuhu na ka treguar për qëllimin për të cilin i ka krijuar të gjitha krijesat dhe ua ka sqaruar shkakun për të cilin e ka krijuar këtë botë dhe çka në të. All-llahu i Madhëruar thotë:

"Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të adhurojnë"(Dharijat: 56)

11) Prandaj adhurimi (ibadeti) është qëllim të cilin duhet ta kryejmë me përpikëri, duke iu nënshtruar All-llahut të Madhëruar dhe duke e falënderuar për atë që na ka dhënë prej begative dhe dhuntive të shumta.

Thotë All-llahu i Lartësuar: ***"Po edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë (të mirat) e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përcaktoni ato."*** (surteun-Nahl 18).

12) Pasi që na u bë e qartë ajo çka kemi sqaruar më parë, obligohemi që ta adhurojmë All-llahun me adhurim të vërtetë dhe që ky adhurim të jetë vetëm për Te duke mos i shoqëruar askënd Atij.

Lutja t'i bëhet vetëm Atij.

Të kemi frikë vetëm prej Tij.

Të kërkojmë ndihmë vetëm prej Tij.

E kështu, të gjitha llojet e ibadetit të jenë vetëm për këtë Hyjni Madhështore, Krijues dhe Furnizues, i Fuqishëm dhe i Fortë, i Cilësuar me cilësi të larta dhe madhështore.

MUHAMMEDI

MUHAMMEDI (sal-lall-llahu alejhi ve selem)

All-llahu xhel-le shanuhu për të na njoftuar me atë çka kërkon prej neve dhe për të na sqaruar atë çka na bënë dobi në jetën tonë, dërgoi disa prej njerëzve të cilët kishin cilësi fisnike dhe moral të lartë që t'i përcjellin urdhrat dhe dispozitat e Tij të gjithë njerëzit, duke filluar prej të afërmve, shokëve, fqinjëve dhe të gjithë atyre që ishin përreth tyre.

E këta ishin ata që i zgjodhi All-llahu i Lartësuar dhe i quajti të dërguar dhe lajmëtarë. I fundit prej këtyre të dërguarve dhe lajmëtarëve ishte i dërguari i All-llahut të krijesat e Tij, prijësi ynë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem, të cilin e dërgoi All-llahu mëshirë për të gjitha botërat, prej njerëzve dhe xhinjëve.

Dërgimi i Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve selem nuk ishte vetëm për popullin apo familjen e tij, por ishte për njerëzit në përgjithësi përgëzues dhe tërheqës i vërejtjes. All-llahu i Lartësuar thotë:

"E ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha botërat."(Enbija: 107).

2) Për ta pasur edhe më të qartë këtë që përmendëm, domosdo duhet të dimë pjesën nga jeta e këtij peygamberi fisnik sal-lall-llahu alejhi ve selem.

Emri i tij është Muhammed ibn Abdull-llahu ibn Abdu-l-Mutalib ibn Hisham, rrjedh nga fisi më i madh prej fiseve arabe, e ai është fisi Kurejsh. U lind në Mekke në siujdhesën arabe, e cila është qytet prej qyteteve të Mbretërisë së sotme Saudite.

U rrit jetim, babai i vdiq sa ishte ende në barkun e nënës. E edukoi nëna e tij Amineja bija e Vehbit me edukatë e cila ishte në pajtim me traditat arabe të cilat shumicën prej tyre i trashëguan nga feja e babait të Pejgamberëve Ibrahimit alejhis-selam. Pastaj i vdiq edhe nëna sa ishte 6 vjeçar e për përkujdesje e morri gjyshi i tij Abdu-l-Mutalibi i cili ishte njëri prej udhëheqësve Kurejshit para shpalljes. Pas dy viteve i vdiq edhe gjyshi e për kujdesje e morri mixha i tij Ebu Talibi.

3) Jeta e tij pas fëmijërisë ishte jetë e dalluar me çdo të mirë. Ishte trim, i singertë, kishte moral të mirë, sa që edhe populli i tij filluan ta quanin "i singerti, besniku".

4) Në fëmijëri ishte bari i deleve, gjë e cila ia shtoi edhe më tepër dëlirësinë e zemrës, udhëzimin në të mirë dhe largimin nga e keqja.

Në rininë e tij punonte për Hadixhen bijën e Huvejlidit, e cila ishte prej grave më të pasura dhe më të dalluara kurejshite. Pasi që e dërgoi në Sham për tregti, Muhammedi sal-ll-

llahu alejhi ve selem pati sukses dhe u kthye me fitim të madh. Kur i mbushi 25 vjet mixha i tij e martoi me Hadixhen e cila ishte më e vjetër se ai 15 vjet.

5) Në moshën 40 vjeçare All-llahu xh.sh e përgatiste për pejgamberllëk, kur filloi të sheh ëndërra të vërteta dhe gjithë atë që e shihte në ëndërr të nesërmen i dilte realitet. Pastaj ia bëri të dashur vetminë, që të mundë të logjikojë dhe të studiojë, ashtu që kalonte një muaj të plotë të çdo viti në një shpellë afër Mekkes e cila quhej "Hira".

6) Pas një periudhe të shkurtër kohore All-llahu xhel-le shanuhu ia dërgoi njërin prej melekëve të mëdhenj, melekun me emrin Xhibril i cili ia shpalli ajetin e parë, e ai është: **"Lexo me emrin e Zotit tënd i cili krijoi (çdo gjë)."**(suretul-Alek 1)

Nga kjo e kuptoi se All-llahu xhel-le shanuhu e kishte zgjedhur që të jetë pejgamber dhe i dërguar i Tij te ky popull.

7) Kështu filloi i dërguari sal-all-llahu alejhi ve selem t'i thërrasë njerëzit që ishin përreth tij në këtë fe. Në fillim thirrja e tij ishte fshehurazi, duke pasur kujdes nga pabesimtarët të cilët adhuronin idhuj dhe gurë. Prej të parëve të cilët iu përgjigjen kësaj thirrjeje ishin: gruaja e tij Hadixheja, djali i mixhës së tij Aliu i biri i Ebu Talibit, shoku i tij Ebu Bekri dhe një pjesë e vogël e popullit të tij.

8) All-llahu xhel-le shanuhu më vonë e urdhëroi që ta shfaq haptazi thirrjen e tij në fenë Islame e cila është fe e All-llahut të Lartësuar dhe për të cilën Ai ishte i kënaqur që të jetë fe e fundit për të gjithë njerëzit.

Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem thërriste në adhurimin e të Vetmit All-llah dhe në thyerjen e idhujve, gjë e cila ishte në kundërshtim me fenë e gjyshërve dhe baballarëve të tyre dhe për këtë ata filluan të bëjnë çmos, ta pengojnë dhe të tallen me te vetëm që ta ndalin nga thirrja e tij, por ai edhe krahas gjithë kësaj duroi. Nga torturat dhe maltretimet e kurejshitëve e mbronte mixha i tij Ebu Talibi, i cili megjithëkëtë nuk e pranoi Islamin dhe vdiq si pabesimtarë.

9) Islami filloi të përhapet shumë shpejtë, sa që atij iu bashkëngjitën edhe disa prej banorëve të Jethribit. Pasi u kthyen në vendin e tyre, Muhamedit sal-lall-llahu alejhi ve selem prapë i erdhën edhe një grup prej 12 vetëve të cilët gjithashtu i besuan dhe kur deshën të kthehen Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem u dha me vete një shokë të tij i cili do t'ua mësonte atyre parimet Islame. Pas pak kohe u përhap Islami në Jethrib dhe një grup prej banorëve të Jethribit i erdhën Muhamedit sal-lall-llahu alejhi ve selem dhe e thirrën që të shkojë tek ata duke iu besuar atij se do ta mbrojnë dhe se do t'i ndihmojnë.

10) Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem iu përgjigj ftesës së tyre dhe i urdhëroi shokët e tij që të dalin nga Mekkeja, ku më vonë edhe ai iu bashkëngjitë atyre. Kurejshitëve posa u arriti lajmi për shpërnguljen e Muhamedit sal-all-llahu alejhi ve selem dërguan disa njerëz që ta vrasin, por All-llahu xhel-le shanuhu si çdoherë e shpëtoi nga ata.

Kur hyri në Jethrib, i cili më vonë u quajt Medinetul- Munevere, banorët e tij i bënë pritje madhështore. Menjëherë pas kësaj e ndërtuan xhaminë e njohur të tij "Xhamia e Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve selem)". Dhe filluan që të thërrasin në Islam dhe ta përhapin atë haptazi. Kurejshitët dhanë përpjekje të mëdha që ta pengojnë thirrjen dhe përhapjen e tij, kështu që dëshiruan ta bëjnë këtë edhe me forcë. Përgatitën fuqi ushtarake që t'i mposhtin muslimanët, por megjithatë All-llahu xhel-le shanuhu u ndihmoi të dashurve të Tij (besimtarëve).

11) Beteja e parë mes Muhamedit sal-lall-llahu alejhi ve selem dhe Kurejshitëve u zhvillua në "Bedr" vend në afërsi të Medinës. Në këtë betejë All-llahu xhel-le shanuhu u ndihmoi muslimanëve kundër pabesimtarëve. Kështu filluan betejat dhe përlëshjet e Muhamedit sal-lall-llahu alejhi ve selem dhe pabesimtarëve. Ndodhën "Beteja e Uhudit",

"Beteja e Hendekut", "Beteja e Hunejnit" e të tjera. Pas çdo beteje fuqia e Islamit shtohet edhe më tepër.

12) Për përhapjen e Islamit edhe më gjerë Muhammedi sal-llahu alejhi ve selem dërgoi disa shokë të tij si misionarë te Kisrau, Kajseri, Nexhashiu e mbretër tjerë prej mbretërive të mëdha që t'i ftojnë në fenë Islame.

13) Në vitin e nëntë të hixhretit muslimanët e çliruan "Mekken" e cila ishte dëshmitarja e parë e fillimit të misionit Islam, por banorët e saj e luftuan dhe u munduan që ta pengojnë Pejgamberin Islam sal-lall-llahu alejhi ve selem. Ajo atëherë konsiderohej si vendi më i madh në të cilin tuboheshin idhujtarët Kurejshit dhe të vendeve tjera.

Me çlirimin e Mekkes filluan që t'i vijnë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve selem delegacione të shumta arabe dhe filluan që të hyjnë njerëzit në fenë e All-llahut grupe-grupe.

All-llahu i Lartësuar thotë: ***"Kur erdhi ndihma e All-lahut dhe çlirimi (ngadhënjimi) dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e All-llahut. Ti pra, lartësoje Zotin tënd duke e falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është Mëshirues i madh."*** (suretun-Nasr: 1-3)

14) Ndërsa në vitin e dhjetë hixhri e bëri haxhin lamtumirës, duke u ligjëruar në te të pranishmëve porositë e tij të fundit, e cila njëherit konsiderohet fjalimi më i gjatë i tij që kishte ligjëruar ndonjëherë mbi çështjet dhe rregullat e fesë.

15) Me 12 rebiu-l-evvel të vitit dymbëdhjetë sipas hixhretit, ndërroi jetë i Dërguari i Zotit sal-lall-llahu alejhi ve selem pas një sëmundje e cila e goditi. U varros në shtëpinë e tij, por sot varri i tij gjindet në brendësi të xhamisë së tij sal-lall-llahu alejhi ve selem.

16) Nga jeta e tij sal-lall-llahu alejhi ve selem me fjalë dhe vepra, dituri dhe punë arriti deri te ne feja e All-llahut të Madhëruar, Islami. Vetëm me nënshttrim ndaj tij është udhëzimi dhe shpëtimi.

Thotë All-llahu i Lartësuar: ***"Nëse i nënshtroheni atij, do të udhëzoheni."*** (Nur: 54)

ISLAMI

Pasi që All-llahu i Madhëruar e zgjodhi Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve selem që të jetë vulë e Pejgamberëve, gjithashtu edhe feja në të cilën ishte ai- e ajo fe ishte Islami- është fe me të cilën është i kënaqur All-llahu dhe njëherit është edhe vulë e të gjitha feve.

Në te është udhëzimi,

Në te është lumturia.

Në te është çdo e mirë,

Në te është shpëtimi.

Thotë All-lahu i Lartësuar: ***"Feja e vetme e pranuar tek All-llahu është Islami"*** (surteu Ali Imran: 19) dhe thotë: ***"E kush kërkon fe tjetër pos Islamit, ajo nuk do t'i pranohet atij dhe ai në botën tjetër do të jetë prej të dëshpëruarve."*** (suretu Ali Imran 85).

2) Me fjalën "fe (din)" nënkuptojmë "rrugë dhe metodë". All-llahu i Lartësuar thotë: ***"Ai (All-llahu) është që dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtet, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhepse e urrejtë këtë idhujtarët."*** (suretu et-Tevbe 33)

Feja është praktikë jetësore e njeriut dhe metodologji e të menduarit të tij.

3) All-llahu xhel-le shanuhu është Krijuesi jonë dhe njëherit Ai e din realitetin tonë. Thotë All-llahu i Madhëruar:

"... e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që dinë Ai të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar..." (suretu el-Bekare 255), do të thotë: Pasi që All-llahu i Madhëruar është Krijues, atëherë ai është më i ditur për atë që është e mirë për neve dhe për atë që s'është e mirë për neve. Gjithashtu është më e ditur për atë që na bënë dëm dhe për atë që na bënë të palumtur.

4) Prandaj feja jonë Islame është fe e cila përfshin në përgjithësi çdo çështje jetësore, është fe e cila nderon njeriun dhe e ngritë atë në shkallë të lartë. All-llahu i Lartësuar thotë: **"Ne me të vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)"** (suretu el-Isra: 70) dhe: **"Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur."** (surtetu et-Tinë: 4).

Prandaj njeriu jeton në jetën e kësaj bote, ndërton në të dhe e udhëheq me atë që e ka krijuar All-llahu në të. E ai në jetën e tij kalon nëpër periodën e provimit, për t'u ditur se a do t'i nënshtrohet Zotit të tij dhe se a do t'i kryen urdhrat e Tij. All-llahu i Lartësuar thotë:

"Gjithçka që është në tokë Ne e bëmë stoli të saj, për t'i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë." (suretu el-Kehf: 7).

5) Kjo botë në të cilën ne jetojmë është vend ku ne në te i kryejmë urdhrat e All-llahut dhe në të largohemi nga ajo që Ai na ka ndaluar. Pas përfundimit të jetës sonë në këtë botë, ekziston edhe jeta në botën tjetër, prandaj ka prej atyre që shkojnë në xhennet dhe ka prej atyre që shkojnë në xhehennem.

Kush i është përgjigjur urdhrave të All-llahut, është larguar nga ajo që Ai ka ndaluar dhe i është nënshtuar Atij, ai do të jetë prej banorëve të xhennetit. E kush i ka kundërshtuar urdhrat e All-llahut të Lartësuar dhe nuk i është nënshtuar Atij, ai do të jetë prej banorëve të zjarrit.

6) Feja jonë Islame përfshin çdo aspekt jetësor. Ajo nuk e ka lënë anash këtë botë, por përkundrazi i ka kushtuar rëndësi të madhe. Ka përcaktuar në te rregulla të cilat e përsosin jetën e kësaj bote dhe të banorëve të saj. All-llahu i Lartësuar thotë: **"Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bënë të këqija në tokë se All-llahu nuk i do çrregulluesit."** (suretu el-Kasas: 77).

7) Feja jonë madhështore, Islami me veçoritë dhe specifikat që i ka, ka bërë që shumë prej pabesimtarëve dhe idhujtarëve të hyjnë në te dhe t'i përmbahen rregullave të saja, për këtë kjo është feja e vetme e vërtet. All-llahu i Lartësuar thotë:

"... e Ai urdhëroi të mos adhuronit tjetër vetëm se Atë. Kjo është feja e drejtë..."
(suretu Jusuf: 40)

Ajo gjithashtu është fe e cila e ngritë njeriun në jetën e kësaj bote. Sa njerëz gjatë shekujve dhe viteve të shumta shijuan lumturinë dhe kënaqësinë me të, e sa të tjerë u dëshpëruan dhe dështuan në kundërshtimin dhe moskryerjen e urdhrave dhe rregullave të saja. **Muslimanët ishin populli (bashkësia) më kualitativ, më i ngritur dhe më i lumtur përderisa iu përmbajtën fesë së tyre.**

8) Me termin "Islam" nënkuptojmë-nënshttrim, dorëzim, ndërsa me termin "musliman" nënkuptojmë atë që i është nënshtuar (dorëzuar) urdhrave të All-llahut dhe njëkohësisht i zbaton ligjet e Tij.

9) Me këtë fe All-llahu xhel-le shanuhu i nderoi të gjitha krijesat. Kjo është fe e plotë dhe rrugë e përsosur. Nuk ka mundësi askush, sado që ka dituri dhe njohuri që të gjejë

mangësi në këtë fe madhështore, ngase All-llahu xhel-le shanuhu e ka plotësuar dhe e ka përsosur këtë fe. All-llahu i Gjithëmëshirshëm në lidhje me këtë thotë në Librin e Tij Fisnik:

"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe jam i kënaqur që islami të jetë fe e juaja." (suretu Maide: 3).

Falënderimi i qoftë All-llahut të Lartësuar për begatinë e Islamit.

IBADETI-ADHURIMI

Pasi që mësuam se në këtë botë nuk gjendemi kot dhe mësuam se Krijuesi ynë është All-llahu xhel-le shanuhu dhe se Ai e dërgoi peygamberin e Tij Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve selem te të gjitha krijesat që t'i thirr ata në fenë Islame, na bëhet e qartë se e kemi obligim që ta adhurojmë këtë Krijues Madhështor, ashtu siç është i kënaqur Ai prej neve, që me këtë ta fitojmë xhennetin dhe të largohemi nga zjarri.

2) Ibadet (adhurim) është të nënshtruarit urdhrave të All-llahut xhel-le shanuhu, zbatimi i asaj me të cilën na ka obliguar dhe largimi nga ajo që na ka ndaluar. Prej llojeve të adhurimit që i kemi obligim janë: namazi, agjërimi, respektimi i prindërve, bamirësia ndaj njerëzve.

Ndërsa All-llahu xhel-le shanuhu na ka ndaluar nga gjërat që janë të ndyta dhe të këqija, prej tyre janë: sharja, hidhërimi i prindërve, vjedhja, keqbërja etj.

3) Ndonjëherë ndokush prej neve e pyet veten e tij: "Përse ta adhurojmë All-llahun të Vetmin, të Lartësuarin?

Përgjigja e vetme është:

" Ngase All-llahu i Lartësuar është i Vetmi Krijues i tokës dhe i qiellit, i kodrave dhe i lumenjve, i njerëzve dhe i shtazëve. Ai, i Madhëruar qoftë, është Sundues i të gjitha krijesave, Krijoi çdo gjë prej asgjëje. Ne gjithashtu e adhurojmë atë të Vetmin sepse Ai, pasi që na krijoi, na dhuroi shumë të mira, na nënshtroi çdo send që është mbi tokë dhe prej saj na caktoi atë që është hallall dhe atë që është haram. Ai është i Cili ka nën pushtet çdo gjë prej vetes tonë dhe atë që posedojnë.

4) Shiko në veten tënde:

A i posedon duart tuaja?

A i posedon këmbët tuaja?

A e sundon ndonjë pjesë nga pjesët e trupit tënd?

Përgjigjja e vetme është: Jo, nuk posedojë asgjë nga kjo.

5) Përse nuk sundon asnjë pjesë nga trupi yt, përderisa ti kur të dëshiron ta kapësh diçka e kap atë me duart me tuaja?! Kur të dëshiron të shkosh në ndonjë vend shkon me këmbët tuaja! Gjithashtu, kur të dëshiron të shikosh në ndonjë send e shikon atë me sytë e tu! Si, pra ato janë të tuat e ti nuk i posedon ato?

6) Ngase ti je krijesë e All-llahut xhel-le shanuhu. All-llahu është Ai i Cili të krijoi ty, duart tua, këmbët tua, sytë e tu dhe të gjitha pjesët e trupit tënd. Ti nuk ke krijuar asgjë nga trupi yt, e as nga ajo që sheh para vetes tënde!

Gjithashtu as njerëzit tjerë nuk e kanë e krijuar veten e tyre, apo ndonjë pjesë të tyre. Krijues është All-llahu i Madhëruar i Cili është larg çdo të mete. Çdo gjë që sheh para teje, njerëz, shtazë, sende, gjithë atë që e posedon dhe e përdorë, nuk është nën sundimin tënd, por është nën sundimin e Zotit dhe Krijuesit të vet.

All-llahu i Madhëruar thotë: **"Vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve e i tokës..."** (suretu Ali Imran: 189). **"Të All-llahut janë ç'ka në qiej dhe në tokë dhe vetëm te All-llahu kthehen çështjet."** (suretu Ali Imran: 109).

Gjithashtu thotë: **"S'ka dyshim se sundimi i qiejve dhe i tokës i takon vetëm All-llahut, Ai jep jetë dhe vdekje..."**(suretu et-Tevbe: 116).

8) Ai është sunduesi ynë dhe sundues i çdo sendi në ekzistencë. Ai është i Cili na bëri obligim nënshtrim ndaj Tij dhe na urdhëroi që mos të adhurojmë askënd përveç Tij.

Për këtë ne e adhurojmë Atë, e adhurojmë nga dashuria që kemi ndaj Tij. All-llahu i Madhëruar thotë:

"Thua: nëse e doni All-llahun atëherë më pasoni mua që All-llahu t'ju dojë..." (suretu Ali Imran: 31). E adhurojmë All-llahun nga lakmia që kemi për xhennetin e Tij. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"...e All-llahu ju thërret për në xhennet dhe falje me lejen e Tij..." (el-Bekare: 221). Gjithashtu e adhurojmë për t'u larguar nga zjarri dhe nga frika prej tij:

"Zoti ynë, atë që Ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar." (suretu Ali Imran: 196).

Atëherë kush është fitimtar në këtë botë, e kush është i humbur?

9) Fitimtar (ngadhënjyes) është ai i cili i kryen urdhrat e All-llahut dhe obligimet që i ka ndaj Tij. I shpëtuar është ai i cili largohet nga ajo që e hidhëron All-llahun xhel-le shanuhu dhe nga ajo që Ai ka ndaluar.

Ndërsa i humbur është ai i cili e kundërshton All-llahun dhe nuk i respekton urdhrat dhe obligimet e Tij. I humbur është ai i cili nuk e adhuron All-llahun xhel-le shanuhu. Ka dështuar ai i cili i then ndalesat dhe bënë mëkate, bënë gjëra të cilat na ka ndaluar Furnizuesi dhe Zotëruesi ynë. Ky është i humbur, ndërsa ai i cili u përmend më parë, ai është i shpëtuar.

All-llahu i Madhëruar thotë: **"...e kush i shmanget zjarrit e hyn në xhennet, ai ka arritur shpëtim..."** (suretu Ali Imran: 185).

Prej llojit të rëndësishëm të ibadetit në të cilën gabojnë shumica e njerëzve është: Duaja (lutja). All-llahu i Lartësuar thotë:

"Zoti i juaj ka thënë: "Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në nënçmuar në xhehnem". (suretul-Gafir: 6).

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem thotë: "Duaja është adhurim".

Prandaj, ti kur të dëshirosh që All-llahu të të jep ndonjë gjë, e thërret Atë dhe thua: "O Zot më fut në xhennet"; "O Zot më shpëto nga zjarri"; "O Zot, fali prindërit e mi!"

Kështu vepron për çdo çështje prej çështjeve të kësaj bote apo tjetrës. Ti kur ta lutësh All-llahun xhel-le shanuhu beson bindshëm se Ai është i Vetmi është Krijuesi dhe Sunduesi yt dhe është i Gjithëfuqishëm që t'i përgjigjet lutjes tënde.

Lutja jote drejtuar All-llahut është ajka e adhurimit tënd dhe sinqeriteti i besimit tënd ndaj All-llahut të Madhëruar.

Për këtë, ti e lutë All-llahun xhel-le shanuhu të Vetmin, nuk e lutë askënd prej krijesave të Tij, nuk kërkon nga askush prej krijesave të Tij dhe nuk kërkon ndihmë nga askush tjetër përveç Tij.

MELAIKET-ENGJUIT

Nga kushtet më kryesore të besimit tonë në All-llahun xhel-le shanuhu është besimi në melaiket (engjujt), njohja e vërtetë e tyre dhe njohja e asaj , me të cilën i ka urdhëruar ato All-llahu xhel-le shanuhu.

Me besimin tonë në melaiket arrijmë gjer te njohja e gjërave më të rëndësishme për të cilat jemi pyetur shumë herë si dhe dëshirojmë të ndalemi para vërtetësisë e tyre.

2) Melaiket janë krijesa prej krijesave të All-llahut xhel-le shanuhu, janë të padukshme, nuk hetohen, nuk kanë ekzistim trupor që shihet e as nuk preken me dorë. All-llahu xhel-le shanuhu i ka pastruar ato nga gabimi dhe devijimi dhe i ka mbrojtur nga mëkatet dhe të këqijat.

Ato nuk janë sikurse njerëzit, nuk hanë, nuk pinë, nuk flenë, janë botë tjetër, botë e cila ndryshon nga bota e njerëzve dhe nga bota e atyre të cilët ne i shohim.

3) Gjëja kryesore me të cilën veçohen melaiket nga njerëzit është: adhurimi i shumtë që i bëjnë All-llahut xhel-le shanuhu, gjithmonë i bëjnë ibadet, pa përtaci.

Thotë All-llahu i Madhëruar: "... **nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.**" (suretu et-Tahrim: 65).

Gjithashtu thotë: "**Atij i bëjnë tesbih natën dhe ditën dhe ata nuk mërzhiten prej adhurimit.**" (suretu el-Fusilet: 38).

Janë krijesa të zgjedhura të All-llahut xhel-le shanuhu për këtë All-llahu xhel-le shanuhu i zgjedhi për ta kryer detyrën më të ndershme.

4) A ka detyrë më të ndershme se përcjellja dhe transmetimi i sheriatit tek të dërguarit dhe lajmëtarët, që t'i thërrasin njerëzit në adhurimin e të vetmit All-llah. Kjo është detyra e ndershme të cilën e zgjedhi All-llahu xhel-le shanuhu për melaiket.

All-llahu i Madhëruar thotë: "**Falënderimi i qoftë All-llahut Sajuesit të melaikeve me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë, ndërmjetësues (në mes Tij dhe pejgamberëve). Ai shton në krijim atë që do, vërtet All-llahu ka fuqi për çdo send.**"(suretu el-Fatir: 1).

All-llahu xhel-le shanuhu nuk ua kishte besuar këtë detyrë po të mos ishin të veçuara me këto cilësi madhështore nga krijesat tjera të All-llahut të Madhëruar.

5) Nga cilësitë tjera që veçohen në krijim e për të cilat na ka informuar All-llahu xhel-le shanuhu janë se ato kanë krahë ashtu siç u përmend në ajetin e lartëpërmendur. Numri i krahëve është i ndryshëm, prej tyre ka që kanë nga dy krahë, nga tri krahë, apo nga katër palë krahë por ka prej tyre që kanë edhe më tepër se caq, e ai është Xhibrili alejhi-s-salam, siç transmetohet në hadithin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve selem se ai e ka parë Xhibrilin i cili i kishte gjashtëqind palë krah.

6) Nga cilësitë e tyre gjithashtu është se ata kanë fuqi që të ngriten dhe të zbresin mes qiejve dhe tokës me shpejtësi të madhe.

All-llahu i Lartësuar thotë: "**Atje ngriten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet (ose lartësia e atyre shkallëve është pesëdhjetë mijë vjet.**" (suretul-Mearixh: 4). Shpejtësia e melaikeve nuk matet e as nuk krahasohet me shpejtësinë e njerëzve, e as nuk ka mundësi për përngjasim apo afrim mes atyre.

7) Nga cilësitë e tyre gjithashtu është se ato janë të krijuara nga drita, siç transmetohet nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem. Posedojnë fuqi të jashtëzakonshme të cilën nuk e ka as njeriu më i fuqishëm nga njerëzit, për këtë tetë prej tyre e mbajnë Arshin (Fronin) e Mëshiruesit, i Lartësuar qoftë. All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Dhe engjëjt (melaiket) qëndrojnë në skajet (anët) e tij, e atë ditë, tetë (melaike) e bartin mbi vete Arshin e Zotit tënd." (suretu el-Hakka: 17).

8) Prej melaikëve ka melaikë të cilat i caktoi All-llahu i Madhëruar për marrjen e shpirtave të njerëzve gjatë vdekjes së tyre. Prijësi i këtyre melaikëve është "Meleku-Mevt (meleku i vdekjes), i cili ka ndihmëtarë tjerë prej melaikëve. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"... derisa kur t'i vijë ndonjërit prej jush vdekja, atij ia marrin shpirtin të dërguarit Tonë dhe ata nuk bëjnë kurrfarë lëshimi." (suretu el-En'am: 61).

9) Nga melaiket, gjithashtu ka melaikë të cilat i dërgon All-llahu xhel-le shanuhu për t'u ndihmuar njerëzve besimtarë. All-llahu i Lartësuar thotë: ***"Edhe kur Zoti yt u kumtoi melaikëve se Unë jam me ju, pra inkurajoni ata që besuan."*** (suretu el-Enfal:12).

Besimi ynë në këtë lloj të melaikëve na bënë që të punojmë që ta meritojmë inkurajimin e All-llahut me melaikë.

10) Prej melaikëve ka të atilla të cilat i ka obliguar All-llahu xhel-le shanuhu që t'i shkruajnë veprat tona, që të shkruajnë të mirat dhe të këqijat tona.

All-llahu i Lartësuar thotë: ***"A mendojnë se Ne nuk e dëgjojmë ndjenjën e fshehtë të tyre dhe bisedën e tyre? Po, e dëgjojmë dhe të dërguarit tonë (melekët përcjellës) që janë pranë shkruajnë."*** (suretuz-Zuhruf: 80).

Besimi ynë në këtë lloj të melaikëve, të obliguara me shkrim na bën që të jemi gjithnjë të kujdesshëm, që mos të biem në ndonjë sherr se përndryshe na e regjistrojnë këtë melaiket kundër neve.

Kjo gjithashtu na bënë që të kemi gjithmonë shpresë dhe nxitje të plotë në kryerjen e veprave të mira, që t'i shkruajnë këto melaiket dhe t'i regjistrojnë.

11) Fjala përfundimtare është se:

Vërtet besimi në melaiket i zgjeron njohuritë e njeriut për sistemin e kësaj gjithësie të cilën e ka krijuar All-llahu xhel-le shanuhu me forma të shumta dhe lloje të ndryshme. Te besimtari është prezente njohja e vërtet dhe kuptimi i shëndoshë për të vërtetat abstrakte të gjithësisë ashtu siç e ka informuar All-llahu xhel-le shanuhu mbi to.

Gjithashtu ky besim vetvetiu na bën me dije se ata të cilët e kundërshtojnë All-llahun xhel-le shanuhu janë të paktë, po edhe në qofshin këta shumica e njerëzve, ngase të gjithë njerëzit nuk mund të krahasohen as me melaiket, e ku mbeten krijesat tjera të cilat të gjitha i janë nënshtruar All-llahut, përveç disave.

Të nënshtruarit, vetëm ata janë me të cilët është i kënaqur All-llahu xhel-le shanuhu dhe të cilët do t'i futë në xhennetin e Tij.

KUR'ANI FISNIK

Kur'ani Fisnik është libër të cilin All-llahu i Madhëruar ia zbriti prej qiellit të dërguarit të Tij Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve selem. Në të është i tërë udhëzimi, e tërë drita, përmban në vete fjalët e All-llahut të cilat kanë për qëllim përmirësimin e krijesave, të mirën e njerëzimit dhe gjithë botërave. Thotë All-llahu i Madhëruar:

"Është e vërtet se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta dhe i përgëzon besimtarët..." (suretu el-Isra: 9).

2) Fjala "Kur'an" e ka rrënjën prej foljes (يقرأ - qara) "për të lexuar", që d.m.th. e shfaq, e qartësoi. Prandaj Kur'ani është qartësim Madhështor dhe shfaqje e haptë, në të cilën janë çiltëruar (kulluar) librat e mëparshme, si Tevratit të cilin ua zbriti All-llahu xhel-le

shanuhu çifutëve apo Inxhilli të cilin ua zbriti All-llahu xhel-le shanuhu të krishterëve. Thotë All-llahu i Madhëruar: **"Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm (Kur'anin) e vërtet që është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantuesi tyre."** (suretu el-Maide: 48).

3) Kur'ani Fisnik është fjalë e Zotit të botëve xhel-le shanuhu, por të folurit e Tij nuk është si të folurit e krijesave assesi. Të folurit e Krijuesit (All-llahut) ndryshon nga të folurit e krijesave dhe nuk i përngjan Atij.

All-llahu i Lartësuar thotë: **"Asnjë send nuk është si Ai."** (suretu esh-Shura 11)

Po ashtu thotë: **"Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu"** (suretu el-Hashr: 21).

4) Kur'ani është libër i udhëzimit, ai na thërret në hulumtimin e argumenteve të All-llahut të Madhëruar, në respektimin dhe nderimin e asaj që ka krijuar Ai, në të logjikuarit e krijimtarisë së Tij. Na thërret në të njohurit e asaj që e kemi të lejuar dhe të ndaluar (hallallit dhe haramit), në veprimin e punëve të mira dhe largimin nga punët e këqia.

All-llahu i Madhëruar thotë: "A nuk e studiojnë ata me vëmendje Kur'anin ? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet." (suretu Muhammed 24).

Gjithashtu thotë: **"Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, por a ka që ndokush që e merr për mësim."** (suretu el-Fet'h: 17).

5) All-llahu i Madhëruar e zbriti Kur'anin e urtë në qiellin e dunjasë në natën e Kadrit, natë e cila është prej netëve të muajit të begatshëm të Ramazanit. E pastaj, pas kësaj, e dërgoi melekun e Tij të madh Xhibrilin e bashkë me te edhe ajete fisnike nga Kur'ani deri te i dërguari jonë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem, ku pas kësaj vazhdoi zbritja e Kur'anit disa vite me radhë.

All-llahu i Lartësuar thotë:

"Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se ç'është nata e Kadrit. Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!" (suretu Kadr:1-3).

6) Vërtet kjo natë e bekuar është më e mirë se një mijë muaj, ngase ajo është nata e zbritjes së Librit Fisnik Përkujtuesit të Urtë, Dritës së Vërtet, te i dërguari i të mirës dhe udhëzimit, i dërguari i Zotit të botëve. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Muaji i Ramazanit që në të (filloi) të shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejt dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)". (suretu el-Bekare: 185).

7) Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve selem vazhdoi t'i zbresë shpallja më tepër se njëzetë vite.

A thua vallë ç'është shkaku i gjithë kësaj?

Kjo ishte nder për Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve selem i cili me këtë ndiente se gjithnjë është nën kujdesin dhe mbrojtjen e Zotit të tij, ngase Ai i cili e kishte dërguar, i Dashuri i tij nuk e harron dhe se Ai është mbrojtësi i tij.

8) Kur'ani i Madhëruar është muxhize (vepër e jashtëzakonshme, të cilën nuk mundet ta bënë njeriu vet. Me muxhize janë shërbyer Pejgamberët me ndihmën e All-llahut për tu dëshmuar popullit të tyre se me te vërtetë janë të dërguar të Tij) për njerëzit dhe për të gjitha krijesat tjera, ngase ai është libri i All-llahut, e të gjithë këta nuk mund të sjellin diç të ngjashëm si ky. Thotë All-llahu i Madhëruar:

"E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne i zbresim robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos All-llahut, nëse jeni të sinqertë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit)."

(suretu el-Bekare:23).

E nuk do të mund asnjëherë të bëjnë një gjë të tillë. As përafërsisht nuk mund ta bëjnë këtë, përkundrazi që ata ishin mu ata të cilët e flitnin gjuhën e pastër arabe, të cilëve u kishte zbritur Kur'ani në gjuhën e tyre, por megjithatë mbeten të gjithë të paaftë.

Thotë All-llahu i Lartësuar: **"Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kur'an arabisht për një popull që di ta kuptojë."** (suretu el-Fussilet: 3).

9) Kur'ani i Madhërishtëm është libër i udhëzimit dhe i të vërtetës. Thotë All-llahu xhel-le shanuhu:

"Thua: Ai (Kur'an) është për besimtarët udhëzues e shërues" (suretu el-Fussilet:44).

Ky udhëzim Kur'anor përfshinë tri ndarje, të cilat përmbajnë gjithë atë që i përmirëson njerëzit në çështjet e kësaj bote dhe problemet e jetës së tyre.

Ndarja e parë: Paraqet besimin i cili është obligim për njerëzit që ta njohin dhe të besojnë në te: si besimi në All-llahun, Melaiket, Librat, të dërguarit dhe Ditën e gjykimit.

Ndarja e dytë: Paraqet dispozitat e sheriatit nëpërmjet të cilave njerëzit adhurojnë Zotin e tyre, njohin atë çka i afron te Zoti i tyre dhe largohen nga ajo që i largon nga Ai.

Ndarja e tretë: Paraqet marrëdhëniet e mira ndërnjerëzore, e ato janë përmirësim dhe pastrim i shpirtit të besimtarit, që ta ngritë nga gjendja e tij, që t'i përforcojë lidhjet vëllazërore dhe ndihmën reciproke mes njerëzve.

E prej këtij morali është: sinqeriteti, durimi, mëshira, bamirësia ndaj prindërve, e të tjera.

10) E obligimi ynë ndaj Kur'anit është: Ta lexojmë atë; t'i studiojmë versetet e tij; t'i kuptojmë urdhrat dhe dispozitat e tij; t'i realizojmë ligjet, obligimet dhe urdhrat e tij; të largohemi nga ajo që na ka ndaluar dhe që nuk e ka pëlqyer për neve, nga e gjithë ajo që e hidhëron All-llahun xhel-le shanunhu.

TË DËRGUARIT DHE LAJMËTARËT

Pasi që All-llahu i Lartësuar krijoi krijesat e Tij, zgjodhi prej njerëzve disa burra që t'ua dorëzojë atyre amanetin e kumtimit të urdhëresave të Tij dhe t'i informojnë njerëzit me atë që e kërkon Zoti prej tyre dhe me atë që i obligon dhe i ndalon nga ajo.

All-llahu i Lartësuar thotë:

"All-llahu e zgjodhi (pejgamber) Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt tjerë (të asaj kohe)." (suretu Ali Imran: 33).

"Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!" (suretu el-Enbija: 25).

2) Qëllimi esencial për shkak të së cilit All-llahu dërgoi pejgamberët dhe i autorizoi lajmëtarët, është të ftuarit e njerëzve në adhurimin ndaj All-llahut dhe të përqendruarit në ligjin dhe programin e Tij. All-llahu i Lartësuar thotë:

"Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: "Adhuroni vetëm All-llahun e largojuni dajve (adhurimit të tyre)." (suretun-Nahl: 36).

E të përqendruarit në fenë e tij nuk është vetëm me namaz e agjërime, mirëpo me çdo gjë me të cilën All-llahu i urdhëroi robërit e Tij, që zemrat e tyre të besojnë në Të, apo t'i kryejnë urdhrat e Tij në veprat dhe punët e tyre. Prandaj, të përqendruarit në fe kërkon të besuarit në All-llahun, në engjëjt e Tij, librat, të dërguarit e Tij, ditën e fundit, e gjithashtu kërkon edhe punët e mira, obligimet e kërkuara, si namazin, agjërimin e të ngjashme me të cilat All-llahu i obligoi robërit e Tij.

3) Te këto obligime, urdhra e mësimet krijesat nuk kanë mundësi që të arrijnë vetëm me mendjet e tyre, pa ndërhyrjen e fjalëve të All-llahut të Lartësuar atyre për ato. Por i mësuar ato me shpalljen e All-llahut të Lartësuar, të dërguarve të Tij, me kumtimin e pejgamberëve të All-llahut urdhrat e Tij drejtuar atyre.

All-llahu i Lartësuar thotë:

"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ju lexojë ajetet e Tij t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të qartë." (Suretul-Xhumua: 2).

E kush i përgjigjet pejgamberëve të All-llahut dhe lajmëtarëve të Tij, ai është prej të shpëtuarve, e kush refuzon fjalët e tyre dhe nuk pranon thirrjet e tyre ai është prej të dështuarve.

4) All-llahu i Lartësuar e ka obliguar muslimanin që të besojë në të gjithë pejgamberët e All-llahut dhe lajmëtarët e Tij, duke mos bërë dallim midis njëri tjetrit, ngase të gjithë janë të dërguar nga All-llahu te krijesat e Tij. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam All-lahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre Pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur." (suretul-Bekare :136).

Gjithashtu thotë:

"I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij..." (Suretu el-Bekare: 285).

5) Mirëpo, nëse beson ndonjëri prej njerëzve në disa pejgamberë, por nuk beson në të tjerët, ai është i gjymtë në imanin (besimin) e tij ndaj tyre, i tilli është pabesimtar, All-llahu atë nuk e futë në xhennet, por e dënon me zjarrin e xhehennemit, All-llahu na mbrojt prej tij. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"S'ka dyshim se ata që nuk besojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes All-llahut dhe të dërguarve të Tij thonë: "Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë" e mes këtij duan të marrim një rrugë. Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë..." (suretu en-Nisa: 150-151).

Ky besim në të dërguarit është obligim për besimtarët i cili i bënë që të dinë numrin e pejgamberëve dhe lajmëtarëve, shpalljet dhe mesazhet e të cilëve parakaluan pejgamberinë e Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve selem, e të besojnë në ta në përgjithësi dhe ta njohin mesazhin dhe pejgamberinë përfundimtare, vulën e mesazheve dhe shpalljeve, e kjo është pa mëdyshje, shpallja dhe mesazhi i të dërguarit Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve selem.

6) Disa prej këtyre pejgamberëve dhe lajmëtarëve, All-llahu i Lartësuar i ka përmendur në Kur'anin Fisnik, kurse disa prej tyre nuk i ka përmendur. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem..." (suretu en-Nisa: 164). E ata për të cilët na ka rrëfyer All-llahu në Kur'an janë: Ibrahim, Is-haku, Jakubi, Nuhu, Davudi, Sulejmani, Ejubi, Jusufi, Musau, Haruni, Zekerijau, Jahjau, Isau, Iljasi, Ismaili, Eljesau, Junusi, Luti, Hudi, Salihu, Shuajbi, Idrisi, Dhulkifli dhe Ademi.

E që të gjithë këta janë 24 pejgamberë për të cilët na rrëfeu neve All-llahu i Lartësuar në Kur'anin e shenjtë.

7) Kurse i njëzetë e pesti prej tyre është vula e të gjithë atyre, i fundit prej tyre dhe zotëriu i tyre e ai është i dërguari i Islamit, mbi të qoftë paqja dhe shpëtimi, i dërguar mëshirë për botërat, për të cilin thotë All-llahu i Lartësuar:

"Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguar i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve..." (suretu el-Ahzab: 40).

E ky i dërguar i All-llahut ka thënë për veten e tij: "Unë jam zotëriu i bijve të Ademit, e nuk është kjo lavdërim."

8) Gjithashtu obligohet për muslimanin që ta dijë se nuk ka pasur popull prej popujve të kaluar në të gjithë shekujt e mëparshëm e që të mos ketë dërguar All-llahu i Lartësuar të dërguar i cili e ka thirr popullin e tij tek All-llahu dhe e ka drejtuar atë kah e vërteta.

All-lahu i Lartësuar thotë:

"... e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar." (suretu Fatir: 24).

"Secili popull kishte të dërguar..." (suretu Junus: 47).

Gjithashtu thotë: **"Pasha All-llahun, Ne dërguam edhe para teje të dërguar ndër popuj..."** (suretu en-Nahl: 63).

Obligohet besimi në të gjithë këta të dërguar, edhe pse nuk iu kanë përmendur emrat në Kur'an të gjithëve.

9) I dërguari të cilin e dërgon All-llahu i lartësuar te populli i tij, është njeri i zgjedhur nga mesi i popullit të tij, mirëpo ai posedon cilësi të larta dhe veçori fisnike, të cilat nuk gjendeshin te askush përveç se tek ai prej popullit të tij. All-llahu i Lartësuar thotë:

"All-llahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe njerëzve. All-llahu dëgjon dhe sheh." (suretu el-Haxh: 75). Gjithashtu thotë:

"Më së miri All-llahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e vet." (Enam: 124)

Pejgamberllëku apo shpallja është dhuratë e shtrenjtë nga All-llahu i Lartësuar, i veçon me të disa prej robërve, e ata- siç u përmend- janë posedues të cilësive me vlera të larta e të plota, që të mund të qëndrojnë përballë obligimeve të shpalljes dhe të jenë shembuj fisnikë që pasohen në çështjet e kësaj bote.

10) I dërguari në të vërtetë është njeri i krijuar nga All-llahu, e godet ajo çka i godet të tjerët: shëndet dhe sëmundje, fuqi e dobësi, jetë dhe vdekje. All-llahu i Lartësuar thotë:

"Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe para tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose nga lufta)? E kushdo që të kthehet prapa nuk i bënë dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t'i shpërblejë mirënjohësit." (suretu Ali Imran: 144).

11) Çdo i dërguar prej të dërguarve që kanë kaluar- si njeri i krijuar nga All-llahu- nuk disponon gjithësinë, e as që ka në dorë dobinë apo dëmin e ndokujt, e as që ndikon në dëshirën dhe vullnetin e All-llahut, e as që din diç nga sekreti, përveç atë që ia ka mësuar All-llahu atij, siç thotë All-llahu i Lartësuar:

"Thuaj unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do All-llahu. Sikur ta dija të fshehtë, do të shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë." (suretu el-A'raf: 188).

12) Që të gjithë këta të dërguar, paqja dhe shpëtimi i All-llahut qoftë mbi ta, kanë qenë të një qëllimi e synimi, e ai ka qenë t'i largojnë njerëzit nga humbja, t'i nxjerrin

ata nga errësira në dritë dhe kanë qenë thirrës në të mirë, drejtues dhe imamë të përmirësimit, ashtu siç i cilësoi Zoti ynë në Kur'anin e lartë:

"Dhe ata i bëmë shëmbëlltyrë që udhëzonin sipas urdhrit Tonë, i orientuam në punë të mira, në faljen e namazit, në dhënien e zeqatit dhe ata ishin adhures Tanë të sinqertë." (suretu el-Enbija: 73).

Çdonjëri prej tyre vinte pas tjetrit që ta plotësojë thirrjen e tij dhe ta përsosë rrugën e tij, derisa All-llahu plotësoi fenë e tij, përfundoi peygamberët dhe lajmëtarët e Tij me vulën dhe zotëriun e tyre, të dërguarin e All-llahut Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve selem, e feja e tij ishte ajkë e feve të mëparshme dhe thirrja e tij ishte thirrje e plotë dhe e përhershme deri në çastin e fundit (ditën e kijametit), siç thotë All-lahu i Lartësuar:

"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, dhe jam i kënaqur që fe e juaj të jetë Islami..." (suretu el-Maide: 3).

DITA E FUNDIT

Besimi në ditën e fundit është kusht esencial prej kushteve të imanit, është pjesë e rëndësishme prej pjesëve të njohjes së robit Zotin e tij.

E si të mos jetë, kur kjo ia vërteton njeriut njohjen e vendit në të cilin do të mbarojë kjo ekzistencë me tokën e saj, luginat dhe malet e saja, me njerëzit dhe gjallesat e saja dhe me të gjitha krijesat tjera.

2) E kur njeriu ta dijë se çka do të bëhet ai me pasurinë, rininë, shtëpinë dhe fëmijët e tij, atëherë do të mund të jetonte jetën e tij ashtu siç dëshiron All-llahu i Lartësuar nga ai, prej adhurimit, nënshtrimit dhe obligimeve me të cilat e ka obliguar All-llahu i Lartësuar atë. Gjithashtu do të mund të përcaktonte qëllimin e tij për këtë botë dhe t'i merr mjetet dhe metodat që lidhen me qëllimin dhe që me to ta arrijë qëllimin (cakun).

E sa i përket atij i cili e ka humbur këtë njohje dhe nuk ndalet para saj, e as që zemra e tij bindet se kjo jetë e ka edhe fundin e saj ku do të mbarojë dhe do të vuloset çdo gjë, atëherë jeta e tij do të bëhet e pavlerë, e paqëllimtë dhe pa cak.

3) All-llahu i Lartësuar na ka sqaruar në Kur'anin Fisnik se Ai i ka krijuar krijesat e Tija për një qëllim më të lartë dhe synim më të plotë. E pasi që Zoti jonë e krijoi njeriun, ia nënshtroi atij çka ka në qiej e në tokë dhe e bëri atë zotërues të tokës dhe të asaj që gjendet në të, a thua vallë e tërë kjo pa ndonjë qëllim dhe pa ndonjë cak? Kjo është çështje prej të cilës na ka larguar All-llahu i Madh.

Thotë All-llahu i Lartësuar:

"A menduat se Ne ju krijuam kot dhe se nuk do të ktheheni te Ne? I lartë është All-llahu, Sundues i vërtetë, nuk ka të adhuruar tjetër veç Tij, Zot i Arshit bujar". (Muminun: 115)

4) Dita e fundit fillon me shkatërrimin e kësaj ekzistence, me ç'rast do të vdesë çdo gjallesë, do të ndërrohet toka dhe do të merr pamje tjetër, e gjithashtu edhe qiejt.

E pastaj All-llahu do t'i ringjallë të vdekurit nga varrezat dhe ua rikthen atyre jetën përsëri. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"A mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie). A nuk ka qenë ai një pikë ujë që derdhet. E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që i ngjall të vdekurit?" (suretu el- Kijame:36-40).

5) E pas kësaj jete tjetër, do ta llogaritë All-llahu i Lartësuar çdonjërin individ prej njerëzve për atë që ka punuar në jetën e kësaj bote prej të mirave apo të këqijave. Ai që është mirëbërës në jetën e kësaj bote, bënë vepra të mira ai edhe do të ngritet me vepra të mira dhe për të gjitha këto All-llahu ia paguan me xhennet.

Ndërsa ai që është keqbërës në jetën e kësaj bote, punon vepra të këqija, nuk e kryen atë që ia ka obliguar All-llahu atij prej mirësive, atë e shpërblen All-llahu për veprat e tij të këqija me zjarrin e xhehennemit.

6) Të besuarit në ditën e fundit është tejet i rëndësishëm, e rëndësia e tij shfaqet me një fotografi të qartë gjatë leximit të ajeteve Kur'anore të cilat u përmendën më parë.

Thotë All-llahu i Lartësuar: **"...por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit..."** (suretu el-Bekare: 177).

All-llahu i Lartësuar e ka ndërlidhur të përmendurit e ditës së kijametit me besimin në Te, e kjo nuk ndodh për tjetër, përpos për shkak të rëndësisë dhe vlerës së saj të madhe. Ai i cili e lexon Kur'anin Fisnik sheh në të ajete të shumta të cilat e përmendin atë dhe flasin mbi të. Pothuajse nuk ka kaptinë që nuk flet mbi këtë çështje e cila i është e afërt mendjeve dhe kuptimeve, herë me argumente e fakte, e herë me sjelljen e shembujve.

7) Lexuesi i ajeteve Kur'anore vërenë se dita e fundit ka edhe disa emra të veçantë dhe çdo emër prej këtyre emrave tregon ngjarjet dhe skenat të cilat do të ndodhin në atë ditë madhështore, në ditën e fundit.

E ajo është "dita e ringjalljes" siç thotë Zoti ynë i Lartësuar:

"E atyre që iu është dhënë dija dhe besimi thonë: "Ju keni qëndruar aq sa u pat caktuar All-llahu deri në ditën e ringjalljes, e kjo pra, është dita e ringjalljes, por ju ishit që nuk e pranoni." (suretuerr-Rrum: 56).

Ajo është "dita e ngritjes, kijametit", ditë kur njerëzit do të ngriten për të dhënë llogari para All-llahut, ashtu siç thotë Ai i Lartësuar:

"E ata që bënë gënjeshtër ndaj All-llahut, do t'i shohësh në ditën e kijametit, fytyrat e tyre të nxira. A nuk është në xhehennem vendi i arrogantëve." (suretu ez-Zumer: 60).

Ajo është "çasti përfundimtar", ashtu siç thotë Zoti ynë i Lartësuar:

"O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti i juaj, sepse dridhja pranë katastrofës së çastit përfundimtar është një llahtari e madhe." (suretu el-Haxh: 1).

Ajo është "dita e llogarisë", siç thotë All-llahu i Lartësuar:

"Musai tha: "Unë iu kam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj që të më mbrojnë prej çdo kryeneçi, që nuk i beson ditës së llogarisë." (suretu Gafir: 27).

E për këtë ditë përfundimtare ka edhe emra tjerë të shumtë përveç këtyre.

8) Kur'ani ka vënë në dukje rëndësinë e gjithë kësaj çështje që ka të bëjë me këtë ditë për shumë shkaqe:

E para: Politeistët (mushrikët) prej arabëve e injoronin dhe nuk e pranin këtë.

E dyta: Besimi në ditën e fundit bënë që jeta të jetë më e fuqishme, kuptimplote dhe e qëllimshme.

E treta: Disa ithtarë të feve tjera të kota e mendonin ditën e fundit si diçka krejtësisht tjetër nga e vërteta që obligohet të pranohet.

9) Ajetet fisnike dhe hadithet peygamberike rrëfejnë se fillimi i ditës së fundit do të bëhet me paraqitjen e ndërrimeve të mëdha të përgjithshme të kësaj bote në të cilën jetojmë me tokën dhe qiellin e saj.

Do të çahet qielli. Do të shkapërderdhen yjet. Do të pëlcasin kodrat. Do të rrënohet çdo gjë.

Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt (në tjerë qiej), e ata (njerëzit) të gjithë dalin sheshazi para All-llahut, Një, Mbizotërues." (suretu Ibrahim: 48).

10) Koha në të cilën do të ndodhë dita e fundit është gjë të cilën e di vetëm All-llahu i Lartësuar e askush tjetër pos Tij, nuk ia ka treguar këtë askujt prej krijesave të Tij, as ndonjë të dërguari apo meleku të afërm. All-llahu i Lartësuar thotë:

"Vetëm Ai e di për katastrofën (për kijametin)." (suretu Fussilet: 47).

Disa prej as-habëve e kanë pyetur të dërguarin e All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve selem për kohën dhe çastin e ndodhjes së saj, madje e përsëritnin pyetjen, e urdhëroi All-llahu i Lartësuar që diturinë rreth saj dhe kohën e ndodhjes së saj ta kthejë vetëm tek Ai, i Lartësuari. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Të pyesin ty (Muhammed) për çastin e fundit (katastrofën e përgjithshme) se kur do të ndodhë ai. Thuaj: "Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk mund ta zbulojë askush pos Tij (e sjell kijametin pa e hetuar askush nga krijesat). Çështja e tij (se kur do të ndodhë) është preokupim i rëndë (për krijesat) në qiej e në tokë. Ajo (katastrofa) nuk vjen ndryshe, vetëm se befas. Të pyesin ty sikur ti di për të. Thuaj: "Për të di vetëm All-llahu, por shumica e njerëzve nuk e dinë (pse është e fshehtë)." (suretu el-A'raf: 187).

11) Pasi që All-llahu i Lartësuar t'ua rikthejë jetën njerëzve përsëri, t'i nxjerrë ata prej varreve të tyre, i tubon dhe i mbledhë afër Vetit, që pastaj çdonjërin nga ata ta llogarisë për atë që ka vepruar.

Do të dëshmojë edhe toka për atë që është bërë mbi sipërfaqen e saj. Thotë All-llahu i Lartësuar: **"Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme, dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendësinë e saj (barrën nga brenda), dhe njeriu të thotë: "Çka kjo (që bënë këtë dridhje)?"** Atë ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë. Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre. E kush punoi ndonjë vepër të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë." (suretu-ez-Zelzele:-1-8).

E jo vetëm kaq, por vërtetë edhe gjuhët do të dëshmojnë, edhe duart do të flasin, e gjithashtu edhe këmbët, lëkurët, deri atëherë kur do t'i pamundësohet ndonjërit gënjeshtria apo ikja. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar. Atë ditë All-llahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se All-llahu është Ai i vërteti, i Qarti në drejtësi." (suretu-en-Nur: 24).

Ja kështu pra plotësohet argumenti i All-llahut ndaj botëve, e ai që ka qenë mirëbërës, xhenneti do të jetë vendi i tij, e ai që i ka bërë mëkat ndaj Zotit të tij do të dënohet me zjarr, e sa përfundim i keq që është ai.

XHENNETI

Xhenneti është vend i gjerë, madhështor të cilin e ka përgatitur All-llahu xhel-le shanuhu për robërit e Tij të cilët i janë nënshtruar në jetën e kësaj bote dhe i kanë rrespektuar urdhërat e Tij. Ai është shpërblim për besimin e tyre të sinqertë dhe punët e tyre të mira. Thotë All-lahu i Lartësuar:

"Dhe ngutuni (me punë të mira) në falje mëkatesh nga Zoti i juaj dhe për një xhenet gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe tokës, i përgatitur për të devotshmit. (Ali Imran: 133)

2) All-llahu i Lartësuar në Kur'anin e Madhërishëm e ka quajtur (xhennetin) me shumë emra: *Xhennetul-meuva, Shtëpia e përhershmerisë, Firdevs, Shtëpia e shpëtimit, Shtëpia e qëndrimit, Vendbanimi i sigurt*, e emra të tjerë.

3) Në xhennet hyn vetëm ai i cili bënë vepra të mira, i cili është i cilësuar me cilësi të mira dhe veçori të lavdëruara me vlerë. All-llahu i Lartësuar thotë:

"All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tëvrat, Inxhil e Kur'an. E kush është më zbatues i premtimit të vet se All-llahu? Pra gëzojuni tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukses i madh. (Të xhennetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinqerisht adhurojnë, ata që falënderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqiat edhe ata që përmbushin dispozitat e All-llahut. Pra, përgëzoi besimtarët." (Et-teube:111-112).

4) All-llahu xhel-le shanuhu e ka cilësuar xhennetin me begati të përhershme dhe kënaqësia në të nuk përfundon, çdo send që është në të është pa llogari (e panumërt) dhe në të ka lumenj të shumtë e të mëdhenj e të llojllojshëm.

Prej tyre ka që e kanë ujin e mirë e të shijshëm, nuk ndryshon era e tij, e as nuk ndryshon shija apo oreksi i tij. Prej tyre ka që janë prej qumështit të pastër e të mirë. Ka që janë prej verës e cila është e shijshme për ata që e pinë, jo sikur vera e kësaj bote e ndaluar, e cila e shkatërron mendjen dhe e humb vetëdijen, gjithashtu nën të ka lumenj nga mjalti i kulluar. E të tjera përveç këtyre, prej lumenjve që rrjedhin nën kështjella. Në të ka pemë dhe mish shpendësh.

5) E prej mrekullive që i furnizon All-llahu xhel-le shanuhu banorët e xhennetit janë këto frute të shijshme që kanë shije të dalluar e të ndryshme të cilat i ngjajnë njëra tjetrës, e banorët e xhennetit mendojnë se ky është ushqim i njëjtë të cilin e kanë ngrënë më parë, por nuk është kështu. All-llahu i Lartësuar thotë:

"E përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira se ata do të jenë në xhennete në të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frytet e tij, ata thonë: "Ky është që me të u ushqenim edhe më parë." Ngase u sillet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë" (El-Bekare: 25).

6) Këtë furnizim të cilin ua përgatiti Zoti i tyre- i Lartësuar qoftë-u jep që t'i shërbejnë djelmoshat, të cilët u përgjigjen kërkesave të tyre dhe ua plotësojnë dëshirat e tyre. Këta djelmosha bartin enë dhe gota nga ari i pastër, të cilat nga bukuria dhe përsosmëria e madhe u ngjajnë margaritarëve të derdhur. All-llahu i Lartësuar thotë:

"Dhe atyre u sillen për shërbim djelmosha që përherë janë të tillë sa që kur t'i kundrosh të duken si margaritarë të derdhur." (El-Enbija: 19).

Dhe thotë: *"Hyni në xhennet, ju dhe gratë tua, të gëzuar! Atyre u shërbejnë me enë e gastare nga ari, aty do të kenë çka t'u dëshirojë shpirti dhe t'u kënaqet syri. Ju do të jeni aty përgjithmonë."* (Ez-Zuhruf: 70,71).

7) Nga begatitë e xhennetit me të cilat i begatoi All-llahu xhel-le shanuhu robërit e Tij të mirë besimtarë, të cilët veçohen prej krijesave tjera

Veshja. Veshja e banorëve të xhennetit është nga mëndafshi i hollë dhe i trashë, e këto rroba i kanë të zbukuruara me ari të kulluar e të pastër.

Gjithashtu vendbanimet e tyre janë të mira, renditja e tyre është e mrekullueshme, ku ka dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën nën të cilat rrjedhin lumenj. Thotë All-llahu i Lartësuar: *"Ndërsa ata të cilët u ruajtën për hir të Zotit të tyre, për ata do të ketë*

dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, nën të cilat rrjedhin lumenj. Premtim i All-llahut, All-llahu nuk then premtimin."(suretu-ez-Zumer: 20).

8) Gjërat që janë në xhennet përngjajnë vetëm në emra me gjërat e kësaj bote, ngase në të ka atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar e as nuk ka mundur ta paramendon mendja e njeriut. Thotë All-llahu i Madhëruar:

"Pra, për ata që kanë vepruar nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është caktuar atyre si shpërblim."(suretu-es-Sexhde:17).

9) Në xhennet nuk ka mëkate e as fjalë të kota. Në të ka vetëm përmendje dhe madhërim të All-lahut. Paqja e All-llahut dhe bekimi i melaikeve është mbi besimtarët e gjithashtu edhe besimtarët e bekojnë njëri tjetrin. Thotë All-llahu xhel-le shanuhu: ***"...ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë.(U thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend."*** (suretu-ez-Zumer: 24).

Prandaj banorët e xhennetit janë banorë të paqes dhe sigurisë, All-llahu xhel-le shanuhu ka nxjerrur prej zemrave të tyre mërzinë dhe urrejtjen ndaj njerëzve. Ata të gjithë janë vëllezër të dashur dhe në xhennet nuk i godet lodhja apo sëmundja.

10) Begatia dhe dhuntia më e madhe të cilën do ta gjejnë besimtarët në xhennet është se ata do ta shohin Zotin e tyre-I Madhëruar Qoftë- dhe do ta fitojnë kënaqësinë e Tij. Thotë All-llahu i Madhëruar: ***"Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara) që Zotin e tyre e shikojnë."***(suretu-el-Kijame: 22-23).

Gjithashtu thotë: ***"...dhe kënaqësi nga All-llahu që është mbi të gjitha."*** (Tevbe: 72).

E kjo është nga plotësimi i begative të All-llahut ndaj robërve të Tij dhe në të njëjtën kohë nder e respekt i Tij ndaj tyre.

11) Xhenneti është i përhershëm nuk kalon, mbetet përgjithmonë. Për këtë arsye edhe banorët e tij janë të përhershëm, nuk iu arrin vdekja e as shkatërrimi. Thotë All-llahu xhel-le shanuhu:

"E për sa i përket atyre fatmirëve, ata janë në xhennet përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, përveç ata çka do Zoti yt (iu dhuron) shpërblim të pakëputur." (Hud: 108)

Fshehtësia e kësaj përhershmërie të banorëve të xhennetit në xhennet është se: pasi që All-llahu xhel-le shanuhu e ka ditur prej zemrave të tyre këmbëngulësinë në besim dhe vepra të mira, sado që të zgjatë jeta e tyre. Për këtë dëshiroi All-llahu xhel-le shanuhu që t'i shpërblejë për qëllimin dhe dëshirën e tyre, edhe pse ai (xhenneti) është më madhështor dhe në shkallë më të lartë, u përcaktoi atyre këmbim që për veprat e mira dhe këmbëngulësinë e tyre në adhurim (nënshttrim) t'ua dhuroj përhershmërinë në xhennet dhe qëndrim në te duke qenë të begatuar, të lumtur dhe të gëzuar.

ZIARRI-XHEHENNEMI

Ai i cili i nënshtrohet All-llahut xhel-le shanuhu, bënë vepra të mira dhe i largohet të këqijave këtë do ta shpërblen All-llahu xhel-le shanuhu me xhennet dhe do t'i dhuroj begati të përhershme duke mbetur në te përgjithmonë dhe nuk do të vdesë kurrë.

Kurse ai i cili e kundërshton All-llahun e Madhëruar, vepron punë të këqija e i lenë punët e mira nuk ka dyshim se All-lahu xhel-le shanuhu do ta ndëshkon atë për veprat e tija të këqija dhe se do ta futë në zjarrin e xhehennemit. Na faltë All-llahu neve dhe juve.

2) Sikurse xhenneti edhe zjarri i ka disa emra:

Ai është **Es-Seir**-zjarr i ndezur fort. **Ledha**- flakë. **El-Havije**-zjarr me nxehtësi shumë të lartë. **Es-Sekar**-zjarr i cili nuk le send pa djegur. Çdo emër prej këtyre emrave dëshmon për ashpërsinë e ndëshkimit.

3) All-llahu xhel-le shanuhu e ka përshkruar zjarrin saktësisht nga i cili thinjën flokët, shqetësohen zemrat, që me këtë të qortohen të devijuarit për devijimin e tyre. Zoti xhel-le shanuhu gjithashtu ka përmendur se lëndë djegëse të tij do të jenë njerëzit dhe gurët. Thotë All-llahu xhel-le shanuhu: **"O ju që besuat, ruani veten dhe familjet e juaja prej një zjarri, lëndë djegëse të të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara"** (suretu-et-Tahrim: 6).

Zjarrit nuk i mjafton vetëm ajo që do të hudhet në të, por do të kërkojë ende, nga madhësia dhe gjerësia që e ka, derisa të mos mbetet asnjë vend i zbrazët. Thotë All-llahu xhel-le shanuhu:

"Ditën kur Ne i themi xhehennemit: "A je mbushur?" E ai thotë: "A ka ende?"(Kaf:30).

4) Edhe banorët e zjarrit hanë, pinë dhe veshën, por...

Çka hanë? Çka pinë? Çka veshin?

Thotë All-llahu i Lartësuar: **"A kjo pritje (me shpërblim prej All-llahut) është më e mirë apo pema e "Zekkumit"? Ne atë e kemi bërë për zullumqarët. Ajo është një pemë që mbin në fund të xhehennemit. Pema (fryti) e saj është sikurse koka dreqërish. E ata do të hanë nga ajo dhe do të mbushin barqet prej saj. Pastaj ata do të kenë kundrejt atij ushqimi edhe ujë të valë. Mandej kthimi i tyre është në xhehennem."**(Safat:61-68).

Pra ushqimi i tyre është:"Zekkum". Ai është dru prej llojeve më të këqija të drunjve, ka shije të idhtë dhe erë të coftirës.

Ndërsa për pijen e tyre, thotë All-llahu i Lartësuar: **"Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr që muret e tij (të flakës) i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhiten fytyrat. E shëmtuar është ajo pije e sa vend i keq është ai."**(suretu-el-Kehf: 29). E ai është bakër i shkrirë të cilin e ka shkrirë zjarri, i cili i këput zorrët e i fërgon fytyrat.

E për veshjen e tyre All-llahu xhel-le shanuhu thotë: **"...e atyre që nuk besuan u qepen rroba prej zjarri, e u hedhet uji i valë mbi kokat e tyre. Që me atë u shkrihet krejt ç'ka në barqet e tyre e edhe lëkurat. Për ata janë edhe kamxhikët e hekurt."**(Haxh:20-22).

5) Kështu është jeta e banorëve të xhehennemit...

Dënim e fatkeqësi. Dëshpërim e ndëshkim.

Nuk vdesin e që me këtë të pushojnë, e as nuk jetojnë jetë të këndshme që me këtë të dëfrehen. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"E do t'i shmanget asaj, ai që është shumë i keq. I cili do të hyjë në zjarrin e madh. Dhe aty as nuk do të vdesë e as nuk do të jetojë." (El-Ala: 11-13).

Dhe thotë: **"është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t'i hudhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne u ndërrojmë lëkura tjera që të shijojnë dënimin. All-llahu është i PlotëFuqishëm i Drejtë."**(suretu-en-Nisa: 56).

6) Ndalu dhe shiko, a do të mund ta prekësh zjarrin apo t'i afroresh atij në shtëpinë tënde? Nëse do ta bëje këtë do të të digjej dora jote. Për këtë t'i largohesh prej tij dhe nuk i afroresh. E ky zjarr prej të cilit t'i ruhesh s'është gjë pos diçka e vogël.

Çka do të bëshë pra? Nuk ka dyshim se largimi yt nga ky zjarr përcëllues do të jetë më i madh se ikja dhe largimi yt nga zjarri i kësaj bote, të cilin e sheh në shtëpinë tënde.

Kur ta njohësh gjithë këtë, dije se zjarri më i madh dhe më i fortë (më përcëllues) në këtë botë as për së afërmi nuk mund t'i afrohet zjarrit të xhehennemit. Thotë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve selem: "Zjarri i juaj të cilin ju e ndezni është pjesa e shtatëdhjetë e vapës së xhehennemit. Një nga të pranishmit tha: "Për (pasha) All-llahun o i dërguar i All-llahut sikur të jetë edhe sa ky (i kësaj bote) do të mjaftonte! Muhammedi sal-lallahu alejhi ve selem i tha: "E këtij do t'i shtohen edhe 69 pjesë tjera, të gjitha me nxehtësi sa ky."

7) Banorët e xhehennemit dallojnë (nuk janë të njejtë) në shkallën ndëshkimit, prej tyre ka që do të kenë ndëshkim të ashpër, disa do të kenë më lehtë se kjo...

Muhammedi sal-lallahu alejhi ve selem na ka lajmëruar për atë që do ta ketë dënimin më të lehtë. A thua vallë çfarë është ai dënim? Si do ta ndien veten ai i cili do të hidhet në të? Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve selem thotë: "Dënimin më të ultë do ta ketë njeriu të cilit do t'i vishen nallet nga zjarri, e nga kjo do t'i vlojnë trutë, ashtu siç vlon uji në enën e bakrit, askush nuk ka parë ndëshkim më të madh, e ky do të jetë ndëshkimi më i lehtë për ta".

8) E besimtarët e mirë të cilët i janë nënshtruar Zotit të tyre, i janë përgjigjur urdhrave të Tij dhe janë larguar nga ndalesat dhe qortimet e Tij, ata nuk do t'i godet asgjë nga kjo. Por... Ka disa nga besimtarët që falen, agjërojnë... por të cilët bien në disa mëkate, kundërshtojnë disa ndalesa dhe i lënë disa obligime... A thua vallë si do të jetë gjendja e tyre? A do të jenë në xhennet apo në zjarr. Thotë All-llahu xh.sh:

"Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa peshoja e një kokrre të melit Ne do ta sjelim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës." (suretu-el-Enbija: 47).

E All-llahu i Lartësuar është më i Urti i të urtëve, më i drejti i të drejtëve... E Ai, i Lartësuar qoftë për ata që do të jenë në këtë gjendje kështu do të gjykojnë; do të peshojnë mes veprave të tija të mira dhe të këqija për të cilat nuk është penduar, e nëse peshojnë më rëndë të mirat atëherë ai do të jetë në xhennet. Por nëse mëkatet e tija janë më tepër do të hynë në zjarr, e pastaj aty do të dënohet aq sa ka bërë mëkate. E pasi që t'ia plotësojë All-llahu xh.sh. dënimin në bazë të drejtësisë dhe urtësisë së Tij, do të del prej aty dhe do të hyjë në xhennet.

9) Zjarri i përhershëm nuk përfundon e as nuk fiket kurrë. Banorët e zjarrit nuk do t'i godet vdekja, e as nuk do të përfundojnë. Thotë All-llahu i Lartësuar:

"E për sa i përket atyre fatkëqinjëve, ata do të jenë në zjarr, aty ata kanë dihatje, kërhamzë të vështirë (në frymëmarrje). Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejtë dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt, vërtetë Zoti yt punon çka dëshiron." (Hud:106-107).

Fshehtësia e mbetjes së banorëve të xhehennemit përgjithmonë në zjarr është se ata ishin kokëfortë (këmbëngulës) në veprimin e mëkateve, e All-llahu xh.sh. u lejoi që të veprojnë atë që kanë zgjedhur, e edhe po të jetonin me qindra vite do të mbeteshin në mosbesimin dhe kokëfortësinë e tyre.

Thotë All-llahu i Lartësuar: **"E sikur t'i shihje ata kur janë ndalur pranë zjarrit e thonë: "Ah, sikur të ktheheshim (në dunja) të mos përgënjeshtrorjmë faktet e Zotit tonë e të bëhemi nga besimtarët. Jo, (s'është ashtu) po atyre u doli në shesh ajo që e mbanin fshehtë më parë, prandaj edhe sikur të ktheheshin ata do të përsëritnin atë që e kishin të ndaluar, e s'ka dyshim, ata janë gënjeshhtarë."** (suretu-el-En'am: 27-28).

Abdesti

Ibadeti më i rëndësishëm vepror, me të cilin All-llahu xh.sh. i obligoi robërit e Tij është namazi. Për kryerjen e namazit ka kushte pa të cilat nuk është i vlefshëm namazi.

Më i rëndësishmi prej tyre është abdesti. Thotë All-llahu i Lartësuar: **"O ju të cilët keni besuar! Kur të doni të ngriteni për të falur namazin, lani fytyrat e tua dhe duart deri në bërryla; fërkoni kokat tua, e këmbët lani deri mbi zogjtë."**(suretu-el-Maide-6).

Pra ai i cili dëshiron të falet patjetër duhet të merr abdes. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem thotë: "All-llahu nuk e pranon namazin pa pastërti (pa abdes).(Transmeton Muslimi)". Gjithashtu thotë: "Nuk ka namaz ai i cili nuk ka abdes.(Transmeton Ebu Davudi)".

2) Abdesti ka rëndësi të madhe dhe shpërblim të madh. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem thotë: "Kur të merr abdes muslimani i dalin mëkatet prej dëgjimit të tij, dorës së tij, këmbës së tij e nëse ulet, ulet i falur prej mëkateve. "Gjithashtu thotë: "Kush merr abdes në mënyrë të përpiktë, i dalin mëkatet nga trupi i tij, sa që edhe prej nënthonjëve të tij."

3) Para se të mësojmë formën e abdestit obligohemi që të dimë një gjë të rëndësishme të cilën shpeshherë e kryejmë para abdestit. E ajo është, kryerja e nevojës. E për kryerjen e nevojës ka rregulla për të cilat na ka mësuar Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve selem, prandaj ai i cili dëshiron ta kryen nevojën e tij, le t'i përmbahet këtyre rregullave.

1) Të hyn në nevojtoje me këmbën e majtë duke thënë: "Bismil-lah, All-llahumme inni eudhubike min-el-hubuthi ve-l-habaith.(Në emër të All-llahut, O Zoti im kërkoj mbrojtje te Ti nga ndyrësitat dhe fëlliqësitat (e exhinëve dhe shejtanëve).

2) Të largon prej vetit gjërat që kanë shenjtëri si mus-hafi e gjëra të tjera.

3) Të ketë kujdes mos t'i spërkat me urinë teshat e tij.

4) Të sigurohet plotësisht se pas kryerjes së nevojës nuk ka mbetur ndonjë pikë urinë në organin e tij.

5) Të pastrohet nga ndyrësitat e urinës dhe nevojës së madhe me ujë, letër apo diç të ngjashme.

6) Nëse dëshiron të pastrohet me letër obligohet që të sigurohet se në letër nuk ka të shkruar diç të shenjtë, ndonjë ajet apo ndonjë hadith, ngase kjo është e ndaluar nuk lejohet, po ashtu duhet të largohet nga letra që ka të shkruar në te diç të ngjashme me atë që u përmend.

7) Të sigurohet se urina apo nevoja e madhe janë ndërprerë plotësisht.

8) Të largohet nga përdorimi i dorës së djathtë gjatë pastrimit dhe ta përdorë dorën e majtë. Mirëpo nuk prish punë ta përdorë dorën e djathtë, që të derdh ujë për t'u pastruar e të tjera.

9) Kur ta kryejë nevojën, të del nga nevojtoja me këmbën e djathtë duke thënë: "Më fal o Zot (Gufraneke)."

4) E pasi që ta ketë kryer nevojën dhe dëshiron që të merr abdes, le të veprojë kështu:

1) Të vendos për marrjen e abdesit me zemër, jo me gjuhë. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem thotë: "Veprat çmohen sipas qëllimit".(Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

2) Të fillojë abdestin duke e përmendur emrin e All-llahut xh.sh. d.t.th.që të thotë **Bismil-lah.**

3) T'i lajë duart tri herë.

4) Ta shpërlajë gojën tri herë.

5,6) Të futë ujë në hundë, ta shpërlajë mirë dhe ta nxjerrë ujin nga hunda duke e bërë këtë një deri në tri herë.

7) Ta lajë fytyrën tri herë duke filluar prej ku dalin flokët deri në fund të mjekrës dhe deri te veshët.

8) Ta lajë dorën prej fillimit të gishtërinjve deri në bërryla tri herë.

9) Ta fërkojë (t'i bie mes-h) tërë kokës deri mbrapa e pastaj të kthehet përpara.

10) T'i lajë veshët ngase edhe ata janë pjesë e kokës.

11) E në fund i lanë këmbët prej gishtërinjve deri te zogjtë.

E kur ta përfundosh këtë, ke përfunduar abdestin tënd.

5) Kur ta përfundojë abdestin, sunnet është që ta thotë këtë dua:

"Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër pos All-llahut të Vetmit i Cili nuk ka shok dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij."

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem ka thënë: "Kush merr abdes në mënyrë të përpiktë e pastaj thotë: Dëshmoj se nuk ka Hyjni tjetër pos All-llahut të Vetmit i Cili nuk ka shok dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij" i hapen tetë dyer të xhennetit dhe hyn nga cila derë të dëshiron." (Transmeton Tirmidhiu).

6) Dëshiroj të përqendrohem në disa gjëra të rëndësishme:

1) Sunnet është për muslimanin që t'i lajë gjymtyrët tri herë por i lejohet edhe nëse e bënë këtë dy apo një herë me kusht që të depërtojë uji në të gjitha pjesët e lara.

2) Preferohet për atë i cili merr abdes që ta përdorë misvakun pas marrjes së abdestit. Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem:

"Mos të frikohesha se do ta rëndoja Ummetin tim do t'i urdhëroja që ta përdorin misvakun pas çdo abdesti." (Transmeton Buhariu).

3) Nuk lejohet për atë që merr abdes që të derdh ujë pa nevojë ngase kjo është (israf) harxhim i tepërt.

4) Larja e qafës të cilën e bëjnë shumica e njerëzve nuk ka kurrfarë baze në fe.

5) Duatë të cilat i thonë disa njerëz gjatë marrjes së abdestit të gjitha janë bid'at nuk kanë kurrfarë mbështetje, përveç duasë pas marrjes së abdestit e cila u përmend më parë.

Gjërat që e prishin abdesin janë:

1) Kryerja e nevojës, qoftë e madhe apo e vogël.

2) Të lëshuarit e erës-lirimi i gazrave (të pordhurit).

3) Të fjeturit (gjumi i thellë).

4) Të ngrënit e mishit të devës. Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem: "Kush han mish deveje le të merr abdes."

Vërejtje: Disa njerëz mendojnë se dalja e gjakut e prish abdesin, kjo nuk është e vërtetë ngase nuk ka argument për një gjë të tillë.

8) I dashur musliman! Më këtë që u përmend deri tash ke mësuar se si të marrësh abdes. Cilat janë gjërat të cilat e prishin abdestin. Gjithashtu ke mësuar rregullat e shariatit të cilat t'i ka mësuar i dërguari sal-lall-llahu alejhi ve selem për kryerjen e nevojës.

Të gjitha këto siç po e sheh edhe vet, janë shumë të rëndësishme, prandaj shpejto që t'i mësosh sa më shpejtë dhe që t'ua mësosh atyre të cilët nuk i dinë. All-llahu të dhashtë sukses në të mirë, vërtetë Ai Dëgjon dhe Përgjigjet.

Namazi

Namazi konsiderohet obligimi më madhështor vepror me të cilin i ka obliguar All-llahu xh.sh. robërit e Tij. Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem: "Mes kufrit (mosbesimit) dhe imanit (besimit) është lënia e namazit".

Muslimanët janë të obliguar që t'ua mësojnë fëmijëve të tyre namazin.

Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve selem: "Mësojuani fëmijëve tuaj namazin kur t'i mbushin shtatë vjet, ndërsa kur t'i mbushin dhjetë vjet detyroni që ta kryejnë këtë..." (Transmeton Imam Ahmedi, Edu Davudi, Hakimi).

2) Namazi me të cilin jemi të obliguar që ta kryejmë ka përgatitje të caktuar, thënie të caktuara dhe lëvizje të caktuara. Thotë All-llahu xh.sh: **"Vërtetë namazi është obligim për besimtarët në kohën e caktuar"**. (suretu-en-Nisa: 103).

D.t.th. obligim me të cilin i ka obliguar All-llahu xh.sh. robërit e tij që ta kryejnë në kohë të caktuar. Nuk lejohet për muslimanin që nga pakujdesia t'i kalon koha e namazit e të del nga koha e tij e caktuar. All-llahu xh.sh. na ka sqaruar përmes të dërguarit të Tij sal-lall-llahu alejhi ve selem kohët e namazit duke filluar nga namazi i sabahut e deri na namazin jacisë.

Ne e dimë se ka hyrë koha e namazit atëherë kur e dëgjojmë muezinin duke thënë:

All-llahu Ekber, All-llahu Ekber, All-llahu Ekber, All-llahu Ekber (*All-llahu është më i madhi*)
Esh-hedu en la ilahe il-lall-llah, Esh-hedu en la ilahe il-lall-llah (*Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut*)

Esh-hedu enne Muhammeden resulull-llah, Esh-hedu enne Muhammeden resulull-llah (*Dëshmoj se Muhammedi është i dërguar i All-llahut*)

Hajje ala-s-salati, hajje ala-s-salati (*Eja në namaz*)

Hajje ala-l-felah, hajje ala-l-felah (*Eja në shpëtim*)

All-llahu ekber All-llahu Ekber (*All-llahu është më i madhi*)

La ilahe il-lall-llahu (*Nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut*).

Me këtë kuptojmë se ka hyrë koha e namazit.

3) Sa i përket përgatitjeve dhe lëvizjeve gjatë namazit jemi të obliguar që t'i marrim ato nga sunneti i Pejgamberit salall-llahu alejhi ve sel-lem .

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: "Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur!" (Transmeton Buhariu).

Prandaj muslimani i cili i është nënshtruar Zotit të tij, obligohet që namazi i tij të jetë në pëlqim të plotë me namazin e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kështu që të jetë i kënaqur nga ai Zoti i tij dhe që ta shpërblejë për punën e tij.

4) All-llahu xh.sh. në shumë ajete Kur'anore na ka sqaruar vlerën e namazit dhe vlerën e kujdesjes ndaj tij, por gjithashtu na ka sqaruar për mëkatën e lënësit dhe atij që është pakujdesshëm ndaj tij. All-llahu i Madhëruar:

"Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj namazit të tyre. Të tillët janë në xhennete dhe janë të nderuar." (suretu-el-Mearixh: 34-35). Dhe thotë: **"Dhe fale namazin, se vërtetë namazi të largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat..."** (suretu-el-Ankebutë: 45).

"Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët. Ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë në namazit të tyre." (suretu-el-Muminun: 1-2).

E ne nuk mund ta kryejmë namazin derisa mos t'i plotësojmë kushtet e tij, ta falim në kohë të caktuar dhe t'i nënshtrohemi etikës së tij.

5) Kushtet e vërtetësisë së namazit:

1) **Abdesti.** Për këtë kemi folur në pjesën e kaluar, prandaj ai i cili dëshiron të falet e nuk ka abdest obligohet që të merr.

2) **Pastërtia e trupit dhe e teshave.** Falësi i namazit obligohet që të kujdeset për pastërtinë e trupit të tij, kështu që mos të mbetet tek ai ndonjë papastërti. Po ashtu e njëjta vlen edhe për teshat dhe vendin ku dëshiron ta kryejë namazin.

3) **Kthimi kah kibleja.** All-llahu i Lartëmadhëruar thotë: **"...e Ne gjithsesi do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (qabja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (qabes) dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni nga ajo anë.** (El-Bekare:144)

E ana e kibles është e njohur (Qabeja në Mekke).

4) **Hyrja e kohës.** Nuk vlen që të falet namazi para se të hyjë koha përkatëse e tij, ashtu sikur që nuk vlen namazi i falur jashtë kohës së tij (përveç me ndonjë arsye). All-llahu i Lartësuar thotë: **"Të mjerët ata të cilët falen. Ata të cilët janë të pakujdesshëm ndaj namazit tyre"** (El-Maun:4-5). Do të thotë e lënë pas dore, e vonojnë nga koha e tij duke mos pasur ndonjë arsye të shariatit.

5) **Mbulimi i avretit** (pjesës së turpshme). Nuk lejohet për falësin e namazit që të falet lakuriq, apo t'i duket avreti. (Avreti është pjesa e cila duhet mbuluar qoftë nëse je në namaz apo para njerëzve, përveç para gruas apo atyre që i ke nën posedim-robërshave. Avret për meshkujt është pjesa prej kërthizës e deri në gjunj, ndërsa për femrat i tërë trupi, përveç duarve dhe fytyrës shën. përkth.).

Nëse cilido kusht prej këtyre kushteve të lartëpërmendura nuk plotësohet apo lihet me qëllim namazi i njeriut është i pavlefshëm. Ndërsa nëse e len ndonjë nga këto kushte nga harresa, gabimisht apo nga padituria, atëherë atij i falet kjo mirëpo obligohet që nëse e ka nga padituria që ta mësojë e mos ta përsërisë më.

6) **Kur t'i plotëson të gjitha këto kushte atëherë vepron siç vijon:**

1) **Vendos** (bën nijjet) **nga zemra e tij duke mos e shqiptuar me gojë**, e këtë me përcaktimin e rekateve, përcakton llojin e namazit, qoftë farz apo sunnet.

2) **Pastaj i ngritë duart deri te veshët dhe thotë: All-llahu ekber** (All-llahu është më i madhi).

3) **Pastaj vendon dorën e djathtë mbi dorën e majtë në gjoks dhe fillon namazin e tij me dua (lutje), duke e falënderuar dhe lavdëruar Zotin, si për shembull: Subhaneke All-llahumme ve bihamdike ve tebarekesmuke ve teala xhedduke ve la ilahe gajruke.** (Qofsh i lavdëruar dhe i falënderuar o All-llah. Emri yt qoftë i bekuar, u lartësoftë Madhëria (Shkëlqesia) Jote. Nuk ka të adhuruar përveç Teje).

4) **Pastaj kërkon mbrojtje tek All-llahu nga shejtani i mallkuar (Eudhu bil-lahi mineshejtanirr-rraxhim**-Me ndihmën e All-llahut mbrohem prej dëmit të djallit (shejtanit) të mallkuar), pastaj e këndon suren El-Fatiha:

"Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim! Elhamdulil-lahi rabbil-alemin! Err-rrahmanirr-rrahim! Maliki jevmid-din! Ijjake na'budu ve ijjake nestein. Ihdinas-sirata-l-mustekim! Siratal-ledhine en amte alejhim. Gajril-magdubi alejhim ve led-dal-lin."

("Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve! Bamirësit të përgjithshëm! Sunduesit në ditën e gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)! Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë. Udhëzona (përforcona) për në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten.") duke ia bashkangjitur edhe disa ajete tjera, apo ndonjë sure (kaptinë) të shkurtër.

5) Kur ta përfundon këtë i ngritë duart prapë deri te veshët, merr tekbir (duke thënë **All-llahu ekber**) dhe shkon në ruku duke i vendosur duart në gjunjët e tij dhe tri herë thotë: **Subhane rabbijel-adhim.** (Qoftë i pastër Zoti prej të gjitha të metave Zoti i Madhëruar dhe i Lavdëruar).

6) Pastaj i ngritë duart dhe ngritet nga rukuja duke u drejtuar plotësisht dhe thotë: **Semiall-llahu limen hamideh. Rabbena lekel-hamd.** (Vërtetë All-llahu dëgjon atë i cili e falënderon. Zoti jonë vetëm Ty të takon falënderimi).

7) Pastaj lëshohet në sexhde duke vendosur në tokë së pari duart e pastaj gjunjët. E kur të lëshohet në tokë vendos në të ballin, hundën, gjunjët dhe duart, e gjithashtu edhe gishtërinjtë e këmbës dhe thotë tri herë: **Subhane rabbijel-a'la.** (Qoftë i pastër prej të gjitha të metave Zoti i lartësuar).

8) Pastaj ngrit kokën nga sexhdeja e parë duke shqiptuar tekbinin (**All-llahu ekber**), vendos duart mbi kofshët afër gjunjëve dhe thotë: **Rabbigfirli verhamni vehdini verfa'ni verzukni** (Zoti im më fal mua, më mëshiro, më udhëzo, më ngre (në pozitë të lartë në xhennet) më furnizo). Apo thotë vetëm: **Rabbigfirli rabbigfirli** (O zot! Falmë, falmë).

9) E kur ta përfundojë këtë atëherë përsëri kthehet në sexhden e dytë dhe vepron njëjtë sikur në të parën.

10) E kur ta kryejë edhe sexhden e dytë e ngreh kokën, e para se të ngritet për në rekatin e dytë ulet pak, duke e shtrirë këmbën e majtë ndërsa gishtërinjtë e këmbës së djathtë i kthen kah kibleja (dhe duke u mbështetur në grushta ngritet për në rekatin e dytë. Shën.përkth.).

11) Kur ta kryejë gjithë këtë muslimani atëherë ka përfunduar një rekat me tri kushtet e tija; qëndrimi në këmbë (kijamin), rukun dhe sexhden.

12) Pastaj në rek'atin e dytë përsëritë tërë atë që e ka bërë në rek'atin e parë, e kur ta përfundon këtë; ulet duke e shtrirë dorën e tij të djathtë mbi gjurin e tij, duke i mbledhur gishtërinjtë e dorës së djathtë, përveç gishtit të tij tregues të cilin e ngritë duke e lëvizur dhe thotë: **"Et-tehijjatu Lil-lahi ve-s-salavatu ve Tajibatu. Es-Selamu alen-Nebijji ve rahmetull-llahi ve berekatuhu. Es-Selamu alejna ve ala ibadil-lahi es-Salihin. Esh-hedu en la ilahe il-la-ll-llahu ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu.** (Përsëritet, duatë dhe fjalët e mira qofshin për All-llahun. Paqja, shpëtimi, mëshira dhe bekimi qofshin mbi të dërguarin (Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve selem). Paqja qoftë edhe mbi ne dhe robërit e mirë. Dëshmoj se s'ka të adhuroar tjetër pos All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij.).

"All-llahume sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed, kema salejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid. All-llahumme barik ala Muhammedin ve ala ali Muhammed kema barekte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid." (O Zot! Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit ashtu siç e ke mëshiruar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtetë ti je i Lavdëruar dhe i Lartësuar. O Zot! Bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç e ke bekuar Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtetë ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar. (Ky quhet Teshehudi dhe salavatet)

13) Pastaj e lutë All-llahun për atë që donë nga të mirat e dunjasë dhe të Ahiretit, duke filluar lutjen e tij me kërkimin e mbrojtjes nga All-llahu prej katër gjërave, nga të cilat ka kërkuar mbrojtje i dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve selem:

"All-llahumme inni eudhubike min adhabi xhehennem ve min adhabi-l-kabri, ve min fitneti-l-mahja ve-l-memat, ve min sherri fitneti-l-Mesihi Dexh-xhal." (O Zot unë kërkoj mbrojtje te Ti nga ndëshkimi i zjarrit dhe nga ndëshkimi i varrit, nga sprovat e jetës dhe të vdekjes dhe nga sprovat e Dexh-xhallit." (Dexh-xhalli është një krijesë e cila do të del para

ditës së gjykimit dhe do të ketë mundësi të shumta. Do të jetë sprovë për njerëzit ngase do të pretendon se është zot. E gjithë këtë do të mundohet ta argumenton me gjëra të çuditshme për njerëzit si ringjallja e të vdekurve. Ai i cili i beson do të hynë në xhehennem përgjithmonë e ai i cili e kundërshton do të jetë prej besimtarëve. Prej kësaj sprove të madhe ka kërkuar mbrojtje i dërguari i Zotit dhe na ka mësuar edhe neve që ta lutemi Zotin me te.)

14,15) Pastaj e kthen kokën e tij në anën e djathtë (jep salam) duke thënë: **"Es-Selamu alejkum ve rahmetull-llahi"** (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi ju) e pastaj edhe në anën e majtë duke e shqiptuar të njëjtën. E me këtë përfundon namazi i tij nëse është dy rek'atësh

16) Ndërsa nëse është tri apo katër rek'atësh, pas këndimit të teshehudit ngritet për në rek'atin e tretë (para se të jep salam) duke marrë tekbir (All-llahu Ekber) dhe duke i ngritur duart deri te veshët dhe duke përsëritur gjithë atë që ka bërë më parë; kryen qëndrimin në këmbë, rukun, sexhden...

17) E kur ta përfundojë rek'atin e tretë apo të katërt; ulet dhe këndon gjithë atë që u përmend, që këndohet në ulje e më në fund jep salam.

7) Disa etika të namazit:

1) Ai i cili falet, mirë është që të shikojë në tokë në vendin e sexhdes, e mos ta ngritë kokën në qiell.

2) Mos të lëvizë tepër në namaz.

3) Që të kujdeset për namazin me xhemat në xhami, ngase namazi në xhami është më i vlefshëm për njëzet e shtatë herë nga ai që kryhet vetëm.

4) Që të kujdeset për dhikrin (përmendjen) pas namazit, si: të thënë Estagfirull-llah (më fal o Zot) tri herë pastaj të thotë: "All-llahume ente es-Selamu ve minke-s-Selamu tebarekte ja dhe-l-xhelali ve-l-ikram." (O Zoti im! Ti je Shpëtimi dhe vetëm prej teje vjen shpëtimi. I Madhëruar qofsh o i Madhëruar e i Nderuar).

5) Nëse falësi falet pas imamit, mos të bënë veprime në namaz para imamit d.t.th. nuk i lejohet që ta parakalon imamin në namaz.

6) Nëse gabon në namaz: shton, mungon apo dyshon p.sh. në numrin e rek'ateve atëherë e plotëson këtë me atë që kërkohet. P.sh. Nëse dyshon se a i ke falur tri apo katër rek'ate atëherë pas përfundimit të duasë (lutjes) në teshehudin (uljen) e fundit i bënë dy sexhde para selamit. Kjo quhet-suxhudetu-s-sehvi.

7) Për t'u kujdesur për namazin obligohesh që ta njohësh numrin e rek'ateve, ato të cilat janë farz (obligative) dhe ato të cilat janë sunnet (vullnetare).

Namazi i Sabahut (mëngjesit)-i ka dy rek'ate sunnet / dy rek'ate farz.

Namazi i Drekës- dy (apo katër) rek'ate sunnet/ katër rek'ate farz/ dy rek'ate sunnet.

Namazi i Ikindsë (i pasdrekës)- katër rek'ate sunnet / katër rek'ate farz/-

Namazi i Akshamit - tri rek'ate farz/ dy rek'ate sunnet/.

Namazi i Jacisë (i mbrëmjes)- /katër rek'ate farz/ dy sunnet dhe tri vitër.

8) Mes namazit farz, sunnet apo vitër nuk ka dallim sa i përket formës përveç nijjetit (vendosjes), ndërsa vendi i nijjetit është zemra siç kemi përmendur më parë.

Këto ishin në mënyrë përmbledhëse dispozitat e namazit, prandaj çdo rob musliman obligohet që të kujdeset për to dhe që t'i kryen ato, por njëkohësisht obligohet që t'i thërret edhe të tjerët në kryerjen e tyre.

E nëse ai e kryen këtë atëherë bëhet rob i mirë i Zotit dhe për këtë do ta shpërblejë All-llahu i Lartësuar me xhennet dhe do ta shpëtojë nga zjarri i xhehennemit.

PËRFUNDUAM ME FALËNDERIMIN E ALL-LLAHUT.